

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIV - Nr. 7553 E premte 8 Qershor 2018 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Banka e Shqipërisë i tha "stop!"
Brënies vërtik të euros në Shqipëri, apo forcimit artificial të lekut në raport me euron. Shpesh ajo ndërhyr në mënyrë ...
Vijon në faqen 20

Nga FATOS ÇOÇOLI

Stop euros?



Dje në Deutsche Welle

Kryeministrat e shtatë vendeve
të industrializuara takohen në Kanada. Situata nuk do të jetë fare e lehtë për shkak të dallimeve me SHBA-në...
Vijon në faqen 21

Nga SABINE KINKARTZ

"G7" - një model që i ka kaluar afati?



Opozita kërkon dorëheqjen, ambasadori i jep mbështetje

Audiopërgjimi, Lu takon Xhafajn: Faktet e provat, hetim të pavarur

"Kjo nuk është arsye për të ndërprerë punën e policisë"

DARINA TANUSHI

Ambasadori amerikan, Donald Lu i shkoi dje në zyrë ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Sipas njoftimit për shtyp të Ministrisë së Brendshme, takimi u fokusua në zhvillimet e fundit në vend dhe veçanërisht në për ...
Në faqen 3

DESHMON QEMAL SELA: VRAVA DY GRABITES, ATA NUK JANE PRINDERIT E MI

TRONDITET DIBRA, DJALI VRET NENEN DHE BABAIN

Shkak, sherri për hotelin te "Llixhat", 26-vjeçari sa ishte kthyer nga Anglia. Pushuesit kosovarë: Pamë tmerr me sy, krismat na rikthyen në mend luftën



(Në foto) Hoteli ku ndodhi vrasja. Autori, Qemal Sela



Në faqen 7

"JA SHQETESIMET TONA"

Paralajmërimi i Bashës:
Së shpejti tronditimi qeverinë, opozita është e kërcënuar

Në faqen 5

STUDIO E HAPUR

Vdes në spital babai i gjyqtarës së vrarë,
letra që iu shkroi pak ditë më parë institucioneve

Në faqen 9

LISTA E DYTE

10 mijë pronarët në Korçë, shqyrtimi nga ATP dhe procedurat për t'u njohur me ecurinë

Në faqen 14-15

DOKUMENTACIONI

Vizat turistike në SHBA, ja sa muaj duhet të qëndroni, ambasada: Kujdes, S'mund të punoni

Në faqen 11

KESHILLI BASHKIAK



Vendimi, ja sa do të rriten pagat e edukatoreve në kopshte dhe çerdhe

Në faqen 13

Ina Xhepa: Ky institucion i arsimit të lartë, ndër më prestigjiozët në vend

BE financon projekt bashkëpunimi me "Luarasin"

Studentët, trajnim 3 ditor dhe certifikata nga Qendra Europiane

Nga VOLTIZA DURO

Kolegji Universitar "Luarasi" ka zhvilluar ditën e djeshme trajnimin "Standardet e procesit të rregullt ligjor si kusht në funksionimin e shtetit të së drejtës". Qendra Europiane ka përzgjedhur Fakultetin e Drejtësisë të



këtij institucioni elitare të arsimit të lartë duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm procesin e promovimit të standardeve të lirisë dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ky trajnim tri ditor vjen si pjesë e pandarë e konsolidimit të shtetit të së drejtës ...

Në faqen 12

PAKTI DETAR AKUZAT

Ish-kryeministri flet për tradhtinë kombëtare: Si falsifikuan Skapi dhe spiuni Muçollari

Valentina Madani

Pakti, Berisha: Grekët po u imponohen shqiptarëve për detin

"Si kërcënoi Rama për largime imediate nga Athina"

Ish-kryeministri Berisha paralajmëroi dje se për marrëveshjen për detin, pala greke po imponohet duke vendosur në tryezë një propozim për të cilin nuk kërkon asnjë diskutim. Jashtë sallës së Kuvendit, ish-kryeministri Berisha akuzoi se ky është tregues i aktit të fundit të tradhtisë të bërë nga kryeministri Edi Rama dhe ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati. Ish-kryeministri Berisha zbardhi disa zhvillime të rëndësishme që sipas tij janë bërë në kurriz të Shqipërisë. "Grekët në mënyrën më arrogante dhe prepotente i kanë dorëzuar palës shqiptare marrëveshjen përfundimtare dhe i kanë thënë: Merreni se për këtë s'ka asnjë koment, asnjë diskutim. Pra, që s'mund ta komentojmë e diskutojmë. Ishulli Othon merr fuqi të plotë, si për ujërat territoriale, ashtu edhe për zonën ekonomike. Ai ishull që bëri zhurmë pala greke i bën të qartë palës shqiptare se ishulli ka të gjithë fuqinë si një ishull të banuar", deklaroi z.Berisha. Si fakt domethënës për besueshmërinë e burimeve që citon, ish-kryeministri përmend edhe deklaratën e bërë nga ministri grek i Mbrojtjes, "Kamenos është një ekstremist, ka thënë se Greqia do të zgjerojë ujërat territoriale. Ndaj kujt do t'i zgjerohet? Sigurisht ndaj Shqipërisë", u shpreh z.Berisha. Ish-kryeministri akuzoi dy bashkëkryetarët e grupit negociator për palën shqiptare se duke marrë urdhra direkte nga kryeministri Rama dhe ministri i Jashtëm po anashkalojnë propozimet që janë diskutuar në dy raundet e negociatave mes dy ekipeve. "Disa anëtarë të delegacionit kanë shprehur refuzimin e plotë, kanë bërë letra për shefat e tyre ku i njoftojnë për imponimin që kërkon të bëjë pala greke. Skapi famoz dhe agjenti Meçollari arrinin që të falsifikonin edhe minutat e diskutimeve, të bindin për të firmosur letra pasi janë hequr gjërat nga aty. Dy persona, secili më i zi se tjetri, Skapi famoz dhe spiuni Meçollari, i njohur se punon në çdo rast kundër Shqipërisë. Nga Edi Rama, anëtarët kanë marrë kërcënime për largime imediate nga Athina dhe bisedime", u shpreh z.Berisha. Në replikë me Berishën, kreu i grupit socialist, Taulant Balla tha se çështja e kufirit me Greqinë është një makth për




Ish-kryeministri Sali Berisha

SALI BERISHA

"Grekët në mënyrën më arrogante dhe prepotente i kanë dorëzuar palës shqiptare marrëveshjen përfundimtare dhe i kanë thënë: Merreni se për këtë s'ka asnjë koment, asnjë diskutim. Pra, që s'mund ta komentojmë e diskutojmë", tha z.Berisha.

Ministri Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe ambasadori Donald Lu, dje në Ministrinë e Brendshme



TAULANT BALLA

Ish-ministri i Jashtëm, Ditmir Bushati nuk preferoi të komentojë deklaratat e ish-Kryeministrit Berisha, i cili përgjigjen në emër të mazhorancës e mori në sallën e Kuvendit nga kreu i grupit parlamentar socialist. "Tradhtinë e bëre ti Sali", tha z.Balla.

Berishës. "I them shumë qartë, makthi yt Sali për marrëveshjen me Greqinë nuk të shpëton dot. I vetmi tradhtar për marrëveshjen me Greqinë je ti Sali", deklaroi z.Balla. Dy ditë më parë,

ministri i Mbrojtjes i Greqisë tha se vendi i tij do të zgjerohet kufijtë detarë, por pa specifikuar hapësirën konkrete. Në fazën aktuale, dy ekipet negociatore të të dyja vendeve kanë zhvillu-

ar një takim në Tiranë dhe një në Greqi pa bërë asgjë publike për çka është arritur. Ata janë mjaftuar me deklarata të dakordësuara se ka frymë të mirë bashkëpunimi.

Të gjitha dyshimet brenda vendeve të Unionit

"Reuters": Tri shtetet që frenojnë hapjen e negociatave me Shqipërinë

Francia, Holanda dhe Danimarka po e frenojnë aktualisht hapjen e negociatave të anëtarësimit. Gjermania është më shumë pro hapjes së tyre. Sipas informacioneve të agjencisë "Reuters", për Gjermaninë janë tri vende momentalisht që e bëjnë të pasigurt hapjen e negociatave të anëtarësimit të BE-së me Shqipërinë dhe Maqedoninë. Ato janë Franca, Holanda dhe Danimarka. Prandaj është e paqartë nëse Komisioni Europian do të japë dritën e gjelbër në samitin e BE në fund të qershorit, thuhet jo vetëm nga qarqe të KE, por edhe të qeverisë gjermane, shkruan "Deutsche Welle". Brenda Berlinit ka zëra kritikë për qëndrimin e Macron se nuk po e dallon rëndësinë gjeostrategjike të Ballkanit



Perëndimor për stabilitetin e Europës, vëren "Reuters". Për Macron, nuk ka interes aq zgjerimi, se sa forcimi i bashkëpunimit brenda BE dhe vendeve të eurozonës. Ndërsa në Bruksel thuhet se, "Macron ka ndjesinë se do t'u hapte krahun djathtë të politikës, sepse për Sh-

qipërinë mendohet menjëherë për kriminalitetin e organizuar", shkruan "Reuters". Edhe qeveria holandeze e argumenton qëndrimin e saj kundër menjëherë me frikërat e brendshme. Komisioni Europian kërkon hapjen e negociatave me Shqipërinë dhe Maqedoninë, sepse të dyja vendet i kanë përmbyshur formalisht kriteret dhe BE duhet t'i qëndrojë fjalës së saj. Por edhe në Gjermani ka dyshime lidhur me hapjen e negociatave brenda Unionit konservator. "Reuters" shkruan se kancelarja gjermane Angela Merkel dhe ministri i Jashtëm, Heiko Mass janë megjithatë për hapjen e negociatave. Nga qarqet qeveritare thuhet se bëhet fjalë për fillimin dhe jo përmblyjen e negociatave që zgjasin me vite.

BE grante për gazetarinë e pavarur, Vlahutin: Do ju mbështesim

Ambasadorja e BE-së, Vlahutin i drejtohet Këshillit të Shqiptar të Medias: "Gazetaria etike duhet të jetë normë dhe jo përjashtim. Gazetarët që ngrenë zërin për standardet etike, duhet të mbështeten dhe jo të marginalizohen". Ajo përmendi se: "Është e rëndësishme të dini se nuk jeni vetëm". Vlahutin tha: "BE-ja e ka mbështetur punën e Këshillit të Medias përmes granteve, ne i kemi ofruar mbështetje Institutit Shqiptar të Medias dhe së shpejti do të fillojmë mbështetjen tonë për transmetuesin publik dhe për shkollën e gazetarisë. Në vitin 2018 dhe për dy vitet e ardhshme, delegacioni i BE-së do të paraqesë gjithashtu një program mbështetës për gazetarinë investigative të pavarur. Përmes granteve, ne do të ofrojmë mundësinë për t'i ndihmuar gazetarët të krijojnë një kulturë më të fortë të produksioneve të pavarura dhe të bazuara në fakte. Gazetaria etike duhet të jetë normë dhe jo përjashtim. BE-ja do t'i mbështesë gjithmonë gazetarët që luftojnë për profesionalizëm dhe pavarësi. Por ndryshimi duhet të vijë nga ju, në praktikën e përditshme të punës suaj. Ne mund të mbështesim sa më shumë që të jetë e nevojshme, por nuk mund ta ndryshojmë realitetin shqiptar", tha Vlahutin.

MBËSHETJA

"BE-ja do t'i mbështesë gjithmonë gazetarët që luftojnë për profesionalizëm dhe pavarësi. Por ndryshimi duhet të vijë nga ju, në praktikën e përditshme të punës suaj. Ne mund të mbështesim sa më shumë që të jetë e nevojshme, por nuk mund ta ndryshojmë realitetin shqiptar", tha Vlahutin.

Por ndryshimi duhet të vijë nga ju, në praktikën e përditshme të punës suaj. Ne mund të mbështesim sa më shumë që të jetë e nevojshme, por nuk mund ta ndryshojmë realitetin shqiptar. Vetëm qytetarët e Shqipërisë mund ta bëjnë këtë, të udhëhequr nga të gjithë njerëzit e ndershëm dhe të përkushtuar, që kujdesen për interesin e këtij vendi shumë më tepër sesa për interesat e tyre personale ose të grupit", deklaroi zj.Vlahutin.



YLLI MANJANI

Ish-ministri i Drejtësisë, Ylli Manjani, paralajmëron se cila do qoftë përgjigja zyrtare për audio-përgjimin ku është i përfshirë vëllai i Fatmir Xhafaj, Agroni nuk do të ketë asnjë vlerë nga ana ligjore. Sipas tij, para se të bëhej ekspertiza e audio-përgjimit, Prokuroria e Krimeve të Rënda duhet të kishte marrë në pyetje dy personazhet që janë pjesë e këtij audio-përgjimi, Albet Veliun dhe Agron Xhafaj.



Ambasadorja shqiptare në SHBA, krah Trump në darkën e iftarit

Ambasadorja e Shqipërisë, në SHBA, Floreta Faber ka qenë e ftuar në darkën e iftarit të shtruar nga Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës Donald Trump. Në këtë darkë me rastin e muajit të Ramazanit, ku kanë marrë pjesë personalitete të ndryshme nga e gjithë bota. Ambasadorja Flabër ka thënë që gjatë darkës së iftarit janë diskutuar edhe marrëdhëniet e forta mes popujve tanë. "Pata nderin dhe privilegjin e madh që të isha pjesë e tavolinës së tij, së bashku me kolegët ambasadorë nga Jordania, Indonezia, Arabia Saudite, Bangladeshi. Prania e Presidentit, diskutimet tepër interesante dhe interesi i tij për secilin nga vendet tona, janë tregues i lidhjeve dhe marrëdhënieve të forta mes popujve tanë. Shqipëria sonte ishte e nderuar të kishte praninë dhe mundësinë e prezantimit të saj në atë tavolinë", u shpreh në një status në rrjetin social, ambasadorja jonë në SHBA. "Theksova se populli shqiptar është tepër mirënjohës ndaj Shteteve të Bashkuara, të cilët kanë mbështetur në çdo hap transformimet rrënjësore të vendit tonë në këto tri dekada të zhvillimeve demokratike. Momentet historik të anëtarësimit të vendit në NATO, të marrjes së ftesës për vend kandidat në Bashkimin Evropian, apo reformat si ajo e drejtësisë, kanë në themel mbështetjen e SHBA-ve. Pata mundësi gjithashtu të theksoj se vëmendja amerikane ndaj Shqipërisë dhe rajonit tonë është një faktor paqje dhe stabiliteti", u shpreh Faber.

Opozita kërkon dorëheqjen, ambasadori i SHBA i jep mbështetjen ministrit të Brendshëm

Audiopërgjimi, Lu takon Xhafajn: Faktet e provat, hetim të pavarur

"Kjo nuk është arsye për të ndërprerë punën e policisë"

Darina Tanushi

Ambasadori amerikan, Donald Lu i shkoi dje në zyrë ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Sipas njoftimit për shtyp të Ministrisë së Brendshme, takimi u fokusua në zhvillimet e fundit në vend dhe veçanërisht në përpjekjet e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, në luftën kundër krimit të organizuar dhe paligjshmërisë. Ministri Xhafaj e njohu ambasadorin me situatën aktuale dhe veprimtarinë e Policisë së Shtetit në këtë luftë. Ambasadori amerikan vlerësoi punën dhe arritjet e Ministrisë së Brendshme dhe Policisë së Shtetit, duke theksuar se është shumë e rëndësishme që kjo e fundit të jetë e motivuar për të vijuar me vendosmëri luftën kundër krimit të organizuar, thuhet në njoftim. Në këtë kontekst, ai shprehu mbështetjen e fortë të SHBA-ve si dhe vendete të tjera partnere për Ministrinë e Brendshme dhe ministrin Xhafaj, në gjithë përpjekjet e tyre për t'ju dhënë qytetarëve më shumë rend e siguri. Ambasadori Lu inkurajoi ministrin Xhafaj dhe Policinë e Shtetit për të vijuar edhe më me intensitet përpjekjet për më shumë rezultate në luftën kundër krimit të organizuar, pasi kjo sipas tij, është ajo çka qytetarët presin sot më shumë se çdo herë tjetër nga Policia e Shtetit. Ai konfirmoi edhe njëherë mbështetjen dhe asistencën e SHBA-ve dhe Agjencive ligjzbatuese për thellimin e rezultateve të deritanishme. Ndërkohë, po dje ambasadori Lu reagoi për herë të parë për akuzat e opozitës ndaj ministrit Xhafaj dhe vëllait të tij, Agron Xhafaj, duke theksuar se të gjitha provat meritojnë të hetohen në mënyrë të pavarur nga organet kompetente. Reagimi ka ardhur në faqen zyrtare të ambasadës së SHBA në Tiranë, ku ambasadori Lu thekson se kjo situatë nuk duhet të jetë një arsye për të ndërprerë punën e policisë dhe prokurorëve për arrestimin e drejtuesve të rrezikshëm të krimit të organizuar. "Po i ndjek me vëmendje akuzat kundër ministrit Xhafaj dhe vëllait të tij, Agron Xhafaj. Faktet dhe provat, përfshirë edhe vërtetësinë dhe rrethanat rreth regjistrimit audio të raportuar, meritojnë të hetohen në mënyrë të pavarur. Por kjo



Ministri Brendshëm Fatmir Xhafaj dhe ambasadori Donald Lu

FATMIR XHAFAJ

Ministri Xhafaj i vlerësoi mesazhet e ambasadorit Lu si mbështetje për atë çka po bën Policia e Shtetit, si dhe shprehje e partneritetit tashmë të konsoliduar mes Shqipërisë dhe SHBA-ve.

Ministria e Drejtësisë merr mbështetjen e autoriteteve gjermane

Deputetët e Bundestagut: Reformat po japin rezultate të prekshme

Ministria e Drejtësisë, Etilda Gjonaj, mori gjatë takimeve në Gjermani vlerësime pozitive për arritjet e Shqipërisë. Ajo u prit në një takim në Ministrinë e Brendshme Federale nga Stephan Meyer, Sekretar Shteti Parlamentar në Ministrinë e Brendshme Federale, si dhe në dy takime në Bundestagun Gjerman nga z. Patrick Sensburg, kryetar i Komisionit për Imunitetet, Zgjedhjet dhe Rregullat Procedurale si dhe z. Johannes Fechner, zëdhënës i Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Mbrojtjen e Konsumatorëve. Ministria Gjonaj i njohu përfaqësuesit e këtyre institucioneve me zhvillimet në Shqipëri dhe përpjekjet për forcimin e shtetit ligjor, luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Gjatë këtyre takimeve u



diskutua propozimi i Komisionit të Bashkimit Evropian për hapjen e pakushtëzuar të negociatave me Shqipërinë, si dhe reformat e thella që ka ndërmarrë qeveria jo vetëm si detyrim në kuadër të këtij procesi, por sidomos për zhvillimin evropian të Shqipërisë. Autoritetet gjermane, si edhe deputetët e Bundestagut, vlerësuan arritjet e Shqipërisë, veçanërisht rezultatet e para të vetingut dhe në rastet e fillimit të ndjekjes penale ndaj zyrtarëve të lartë publik, si dhe mbështetjen fort vijimin e reformave

që ka ndërmarrë Shqipëria që garantojnë forcimin e shtetit ligjor, luftë kundër kriminalitetit, emigrimit të paligjshëm si dhe krijimin e kushteve për zhvillimin ekonomik dhe pjesëmarrjen në tregun e përbashkët evropian. Z. Sensburg u shpreh i gatshëm për të mbështetur në çdo formë përpjekjet për promovimin e arritjeve të Shqipërisë jo vetëm me zyratë publike në Gjermani, por edhe me qytetarët e tjerë gjermanë për të kuptuar proceset e rëndësishme që po ndërmerr Shqipëria si dhe efektet që kanë këto procese edhe në vendet e tjera të Bashkimit Evropian. Nga ana tjetër, z. Fechner vlerësoi reformat e ndërmarrura deri më tani duke theksuar se do t'ia përcjellë të gjithë kolegëve të tij rezultatet e prekshme të arritura si pasojë e këtyre reformave.

nuk mund të jetë arsye për të ndërprerë punën e policisë dhe prokurorëve për të arrestuar drejtues të rrezikshëm të krimit të organizuar. Koha që Shqipëria të përfundojë punën që ka nisur është tani", u shpreh dje ambasadori Lu. **VIZITA** Gjatë bisedës, ambasadori Lu shprehu dëshirën për të parë nga afër veprimtarinë e Task Forcës Speciale, të ngritur në kuadër të operacionit "Forca e Ligjit". Bashkë me ministrin Xhafaj, ata janë larguar nga ministria me të

njëjtën makinë për të organizuar një vizitë e shkurtër në ambientet e TFS. Ambasadori Lu, duke iu drejtuar të pranishmëve, në referencë të luftës që SHBA-të kanë bërë dhe po bëjnë ndaj kriminalitetit, u shpreh se "mënyra më efektive për të pasur sukses, është ngritja e strukturave me përbërje oficerësh policie elitare, prokurorësh elitare dhe bashkëpunim efektiv me Agjencitë e tjera ligjzbatuese". "Të njëjtën gjë, vijoi ambasadori, jeni duke e bërë dhe ju këtu, në Sh-

qipëri". Në këtë kuadër, ambasadori inkurajoi efektivitetin e TFS-së për të vijuar me vendosmëri luftën kundër krimit të organizuar. "Jam i impresionuar nga veprimtaria juaj dhe nga fakti se nuk po u tundoheni lidhjeve të elementëve kriminalë me politiken. Keni mbështetjen tonë të plotë, të misionit IC-ITAP dhe Agjencive të tilla si FBI dhe DEA. Shpejt, Ju do të ndiheni krenarë sesi Task Force Speciale do të ndryshojë të ardhmen e vendit", theksoi ambasadori.

ÇESHTJA "XHAFAJ" BLLOKIMI

Debati, Berisha-Ramës: Mos u fshih pas Pandeliut. Basha: Marku si Speedy Gonzales

Opozita bllokoi Kuvendin, PS voton me urgjencë projektligjet dhe largohet

Ruçi, Bashës: Sillu si lider, mos mbaj peng Kuvendin!

Valentina Madani

Kuvendi votoi dje sërish mes kaosit projektligjet e rendit të ditës. Opozita bllokoi sërish foltoren e parlamentit për afro 3 orë. Edhe pse kreu i PD-së, Lulzim Basha vijoi që të flasë dhe opozita kishte bllokuar foltoren, kreu i Kuvendit Gramoz Ruçi hodhi në votim pikat e rendit të ditës me shpejtësi. Seanca u ndërpre tri herë, pasi Basha kërkoi fjalën, por sa herë u ndërpre nuk u largua nga foltorja, por kërkoi kohë shtesë. PD kërkoi që në seancë të jetë i pranishëm kryeministri Rama dhe ministri Xhafaj. Nga ana e tij, kreu i Kuvendit, Gramoz Ruçi i kërkoi PD që të zyrtarizojë kërkesën dhe Rama do të jetë i gatshëm për interpelancë. Ruçi i bëri thirrje Bashës të sillte si lider dhe ndërpreu seancën. "Bëni kërkesë me shkrim dhe unë do ta planifikoj siç janë rregullat. Nëse do të vazhdoni skenarin tuaj për të krijuar anomali, them se nuk keni për ta realizuar. Maksimumi do shtyni me një javë raportimin e institucioneve. Ju lutem, Basha jepni kontributin si lideri i opozitës për të mos marrë peng sallën e opozitës. Institucionalizoni kërkesën për interpelancë, ose mocion me debat unë do t'i vendos në axhendë. Këni 25 orë kohë për të folur, lëre këtu skenar", theksoi z.Ruçi. Pas insistimit të Lulzim Bashës, kryeministri Edi Rama mbërriti në Kuvend. Përpara se të ulej në vendin e tij, kreu i qeverisë takoi për disa çaste ministrin e Shtetit për Diasporën, Pandeli Majko. Ky moment nuk është kaluar pa u komentuar nga ish-kryeministri Sali Berisha, i cili u drejtua Ramës: "Mos u fshih pas Pandeliut". Nga ana e tij, z.Basha akuzoi kryeministrin Rama se po pengon dhe saboton integritetin duke ruajtur marrëdhëniet me kriminelët. Basha shtoi akuzat në adresë të kryeprokurores Arta Marku, duke e quajtur



Kreu i Opozitës, Lulzim Basha

PËR ARTA MARKUN

"Speedy Gonzales, Arta Marku u vu në lëvizje, se skenari i Ramës parashikonte fshehjen të nesërmen jashtë Shqipërisë të Agron Xhafajt. Prokuroria Rama-Xhafaj-Marku i transferoi materialet te Krimet e Rënda, vetëm pasi u sigurua që Agron Geron Xhafaj u përcoll me ndërime policore dhe iku jashtë vendit", tha z.Basha.



Seanca e djeshme parlamentare

DEBATI BASHA - BRAÇE

Z.Basha debatoi me socialistin Braçe: "Me skenarin e komplotit kriminal në të cilin po zhyten ditë për ditë dhe në raport me pengesën që i kanë vënë aspiratës së shqiptarëve për integrimin evropian! Ti pusho, mos fol nga vendi! Mos bëj trimin këtu! Pusho! Qepe gojën! Qepe gojën! Hajde këtu, hajd...!" Braçe ka thirrur nga vendi ku ishte ulur... "Ti ke vrarë njerëz"! Por Basha u përgjigj "Zar i bandave të Lushnjës, pusho! Hajde, hajde këtu! Ta tregoj unë ty! Zar i bandave të Lushnjës!".

Debati, Balla: Po bën zhurmuesen. Kryemadhi: Nuk jam marrë me motrën, as me gruan tënde

Përplasjet mes mazhorancës dhe opozitës dje nuk munguan jashtë salle, këtë herë mes Ballës dhe Kryemadhit. Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, është përplasur dje me kreun e grupit parlamentar të PS, Taulant Balla, jashtë Kuvendit. Teksa Balla po fliste për gazetarët, Kryemadhi iu afrua dhe po i rrihte shpatullat duke kërkur që të flasë. Por Balla ka thënë se ajo është bërë zhurmuese dhe ai shprehu keqardhjen. Ndërsa Kryemadhi i ka përmendur motrën dhe gruan. Por dje kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, deklaroi se kryeministri Rama është bërë një kopje e kriminit dhe opozita nuk duhet t'i ndahet me denoncime. Kryemadhi shkruan në 'FB' se: Ngjyra e kostumit fiks si blua e Olsit



Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi

te makina e kuqe e Gent Xhixhës. "Jam live nga parlamenti, në fakt kjo sallë është bërë shumë qesharake, ka ngelur në dorë të një bataktiu si Edi Rama, i cili sot është veshur me kopjatin, sepse nuk i ka mbetur gjë tjetër vetëm të bëhet një kopje e shëmtuar e kriminit të organizuar. Ky njeri është i paaftë për të drejtuar Shqipërinë dhe i ka drejtuar drejt rrugës së varfërisë, drejt rrugës së kriminit dhe drejt rrugës së mungesës së identitetit kombëtar. Megjithatë, ajo çka dua të them

dhe që është shumë e rëndësishme, është që nuk duhet të ndalemi asnjë minutë. Jo vetëm për ta denoncuar dhe ta demaskojmë këtë fytyrë monstruoze të kriminit të organizuar, i cili ka uzurpuar jo vetëm qeverisjen, por edhe parlamentin shqiptar. Prandaj e bëj këtë thirrje nga kjo sallë, me qetësi, por me vendosmëri për t'u bindur dhe për t'u ngritur kundër këtij sistemi kriminal dhe kundër këtij sistemi uzurpator, i cili ka uzurpuar jetën e shqiptarëve", tha zj.Kryemadhi.

DEBATI BALLA-KRYEMADHI

MONIKA KRYEMADHI: Mund të flasim edhe ne.
TAULANT BALLA: Edhe ti do flasësh se ta zuri vendin Luli në Kuvend.
MONIKA KRYEMADHI: Po do flasim...
TAULANT BALLA: Më vjen shumë keq që bashkëshortja e presidentit ka vendosur të bëjë zhurmuesin, por ky është fati i keq i opozitës.
MONIKA KRYEMADHI: Taulant nuk jam marrë as me motrën tënde, as me gruan tënde. Në rregull. Rri urtë!
TAULANT BALLA: Më pëlqen edukata juaj.
MONIKA KRYEMADHI: Edukata ime është shumë e mirë, por mos u merr me çështje familjare, se nuk e dimë si dalim pastaj. Rri urtë! Nuk të shpëton Edi Rama. Edhe nuk bëhesh dot ministër i Brendshëm ti, t'i zësh vendin Fatmir Xhafajt.

atë Speedy Gonzales, si personazhi në filmat e animuar: "Speedy Gonzales, Arta Marku u vu në lëvizje, se skenari i Ramës parashikonte fshehjen të nesërmen jashtë Shqipërisë të Agron Xhafajt. Prokuroria Rama-Xhafaj-Marku i transferoi materialet te

Krimet e Rënda, vetëm pasi u sigurua që Agron Geron Xhafaj u përcoll me ndërime policore dhe iku jashtë vendit", tha z.Basha. Ish-kryetarja e grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Edmond Spaho, që përmendi në parlament vendet skeptike ndaj

Shqipërisë. Por në këtë pikë mori përgjigje nga kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi. "Vendet anëtar të BE, veçanërisht vendet kryesore kanë paraqitur një sërë rezervash ndaj Shqipërisë, duke filluar nga Presidenti i PE-së, presidenti i Këshillit Ekzekutiv dhe

më pas vende të tilla si Gjermania, Holanda, Franca", tha z.Spaho. Kurse z.Ruçi tha: "Flisni në emër të Gjermanisë, por në dijeninë time qeveria gjermane ka vendosur ta mbështesë hapjen e negociatave për Shqipërinë". Në kushtet kur opozita bllokoi foltoren,

mazhoranca tërhoqi diskutimet ndërsa kaloi në votimin e rendit të ditës. Edhe pse seanca u mbyll, debati vazhdoi jashtë sallës së Kuvendit, këtë herë mes kryetarit të grupit parlamentar socialist, Taulant Balla dhe kryetares së LSI-së, Monika Kryemadhi.



SI VEPROI PROKURORIA SIPAS BASHËS BRENDA 24 ORËVE NËN URDRHRAT E FATMIR XHAFAJ PËR TË MBROJTUR TË VËLLAIN

PROKURORIA RAMA-XHAFAJ-MARKU:

- 1 - Lejoi largimin nga Shqipëria të Agron Xhafajt pa guxuar ta marrë atë në pyetje si trafikant drogë, pa e nxjerrë me zë e figurë përpara shqiptarëve dhe pa e ballafaquar me dëshmitarët e çështjes.
 - 2 - Pranoi në fshetësi të plotë "mostrat" e zërit të regjistruara privatisht në mes të natës, edhe pse për t'u realizuar ekspertiza kërkohet që regjistrimi të kryhet në të njëjtat kushte dhe me të njëjtat pajisje, siç është bërë edhe përgjimi fillestar.
 - 3 - Vuri në dispozicion të trafikantit në mes të natës prokurorët e Prokurorisë së Tiranës, të cilët nuk guxuan të kërkonin asnjë provë që zëri i regjistruar si kampion eksperimental është ajo jo i Agron Xhafajt.
 - 4 - Brenda natës (15 maj 2018) Prokuroria e Tiranës me urdhër të treshes Rama-Xhafa-Marku:
 - Regjistroi kallëzimin penal të Agron Xhafajt për "kallëzimin të rremë".
 - Hodhi shortin për caktimin e prokurorit.
 - Prokurori i caktuar mori në dorëzimin dosjen dhe shqyrtoi materialet fillestare.
 - Prokurori vendosi të regjistrojë procedim penal.
 - Prokurori vendosi të kryejë veprime hetimore, siç ishte administrimi i dëshmisë së Agron Xhafajt.
 - Prokurori vendosi të marrë në pyetje dëshmitarin Albert Veliu, ende pa u bërë publik identiteti i tij.
 - Prokurori vendosi të kryejë një tjetër veprim hetimor siç ishte vendimi për ekspertim.
 - Prokurori vendosi të caktojë ekspertin.
 - Prokurori vendosi të pranohet mostrat e zërit.
 - Prokurori vendosi transformimin e çështjes pas kësaj për në Prokurorinë e Krimeve të Rënda.
- Të gjitha këto u kryen brenda 24 orëve, sepse skenari kriminal i Edi Ramës parashikonte fshetjen të nesërmen (16 maj 2018) jashtë Shqipërisë të Agron Xhafajt.
- Si po i mbrojnë prokuroria Fatmir dhe Agron Xhafajt.**
1. Prokuroria nisi çështjen për trafik droge ndaj Agron xhafajt vetëm pasi ai u largua nga Shqipëria.
 2. Dërgoi për ekspertim materialet që i caktoi Edi Rama dhe ia dorëzoi të gatshme nëpërmjet Agron Xhafajt.
 3. Dërgoi për ekspertizë materialet e çështjes atje ku urdhëroi Edi Rama, duke mos guxuar që të zgjidhte ajo vetë laboratorin se ku duhet të kryhet ekspertiza dhe duke mos përdorur edhe precedentët e mëparshëm të bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë (FBI).
 4. Nuk guxoi kurrë të verifikonte tabulat telefonike të Agron Xhafajt apo qelizat telefonike të tij për të përcaktuar nëse Albert Veliu (dëshmitari X) dhe Agron Xhafaj kanë komunikuar apo jo së bashku dhe nëse kanë qenë apo jo në të njëjtën vendndodhje ditën dhe orën e realizimit të përgjimit ambiential. Do të mjaftonte kjo për të qartësuar se audio-përgjimi ka dy protagonistë, Albert Veliu që u pranoi me zë e figurë dhe Agron Xhafaj, të fshehur me urgjencë me urdhër qeveritar.
- Basha tregon si është paracaktuar rezultati i hetimit.
- "Të dhënat tona të besueshme, të konfirmuara edhe nga disa burime, përfshirë partnerët ndërkombëtarë, konfirmojnë se Fatmir Xhafaj ka paracaktuar rezultatin final të hetimit".
- Ashtu siç ka urdhëruar dhe paralajmëruar edhe Edi Rama:
- Audio-përgjimi do të vlerësohet jo autentik, kësaj here edhe me vull të prokurorisë Rama-Xhafa-Marku.
 - Zëri i Agron Xhafajt do të dalë zëri i Arta Markut.
 - Trafiku i drogës do të konsiderohet eksport bananesh.
 - Trafikanti Agron Xhafaj do të shpallat aktor e më pas qytetar ndëri.
 - Fatmir Xhafaj do të kurorëzohet ministër kampion në luftën ndaj trafikut të drogës.

Survejimi, kreu i PD: Opozita e kërcënuar, shqetësuese janë paratë e drogës

Paralajmërimi i Bashës: Surpriza e madhe, së shpejti tronditim qeverinë!

"Olsi Rama udhëtoi në makinë me trafikantët e Xibrakës"

Valentina Madani

Kreu i PD-së Lulzim Basha, paralajmëroi mbremë një denoncim të fortë që opozita shqiptare do të publikojë pas versionit zyrtar të audio-përgjimit, ku përfshihet drejtpërdrejt për trafik droge Agron Xhafaj, vëllai i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj. Basha deklaroi në 'Opinion' se pritet të shpërthejë diçka e madhe, e cila do t'razojë nga themelet qeverinë socialiste. "Ata do të thonë ka qenë ky, s'ka qenë Agron Xhafaj. Por pas kësaj do të ketë një surprizë të madhe. Pasi ata të bëjnë këtë lojë, do të kemi një surprizë të madhe. Kjo surprizë do të vijë andej nga nuk e pret. Pasi ta shpallin të pavlefshëm audio-përgjimin, pasi Edi Rama ka përcaktuar linjën politike duke thënë se nuk është i vërtetë. Pas kësaj loje, do t'u vijë andej nga nuk e presin. Dhe jam shumë serioz me këtë. Nuk do të ishte surprizë nëse e them që sot" - tha Basha. Ndërsa tjetra kreu i PD-së akuzoi se i vëllai i kryeministrit të vendit, Olsi Rama ka udhëtuar me trafikantët e Xibrakës. "Informacioni që ne kemi bërë publik është që afëra e kokainës së Maminasit është një aferë e cila vërteton në radhë të parë, krimin e organizuar shqiptar me mbështetjen e qeverisë shqiptare, i cili është ngritur një shkallë më lart, që është shkalla e trafikut më të madh në botë. Ta marrë dhe ta porosisë direkt nga Kolumbia drogën. Kjo nuk ndodh kurrë që një ngarkesë kaq e madhe të mbërrijë pa pasur më parë ngarkesa më të vogla që kalojnë të gjitha hallkat. Kjo tregon se rruga për të kaluar kokainën ishte e testuar dhe e garantuar. E dyta, kjo nuk ndodh kurrë pa garancinë e nivelimit të lartë. Dhe niveli i lartë nuk është ministri i Brendshëm, pasi ai nuk ka kaq fuqi, por implikimi shkollor deri tek kryeministri i vendit. Andaj, droga e Maminasit është njësoj e lidhur drejtpërdrejt si me rastin e drogës së Xibrakës, e lidhur me familjen Rama. Për të parë për Xibrakën, duhet të pyesësh Saimir Tahirin, sepse është karta më e fortë që është arritur pakti mafioz Rama-Tahiri. Çështja e Xibrakës kompromenton drejtpërdrejt Olsi



Kreu i Opozitës, Lulzim Basha, dje në "Opinion"

Ramën, i cili është dokumentuar përmes sistemeve të policisë kriminale dhe kufitare në rrethana bashkëpunimi dhe bashkëudhëtimi me të dënuar kryesor dhe të arratisur kryesor tha z.Basha. Lidhur me survejimin e tij nga Policia e shtetit, deklaroi se deputetët e PD-së i kanë dhënë një paralajmërim të prerë

drejtorit të policisë. "Nuk mendoj se është një çështje që meriton një diskutim sonte. Një nga gazetat kryesore në vend, (Panorama) ka publikuar ditën e premtën në mëngjes lajmin. Pas kësaj deputetët e PD-së kanë marrë kontakt me drejtorin e përgjithshëm të policisë dhe i kanë dhënë një paralajmërim të prerë që nëse policia vazhdon të

funksionojë si një bandë private në shërbim të Xhafajve dhe kryeministrit, për të mos bërë detyrën në raport me krimin e organizuar dhe terrorizmit dhe vihet në funksion të një procesi ndaj opozitës në tërësi apo kryetarit të opozitës në veçanti, do të mbajnë përgjegjësi ligjore". -tha Basha në "Opinion". Sipas tij ajo që është për t'u shqetësuar këtu nuk ka të bëjë me personin tim, po me familjen time, janë para, të cilat harxhohen nga taksapaguesit shqiptarët, ndërkohë që këta policë paguhen për të luftuar krimin dhe terrorizmin. Një lajm i tillë konfirmim. "Unë nuk i jap asnjë vlerë kësaj, në 5 vjet unë dhe opozita jemi hasur me kërcënime, presion dhe forma të ndryshme shantazhi dhe nuk me shqetëson aspak, por shqetësues është fakti se ku ka degraduar ky shtet ku me paratë e taksapaguesve shqiptarë në vend që të luftohet krimi dhe të ndiqen kriminelët, bandat trafikantët...", theksoi kreu i PD-së.



Negotiatat, Basha: Isha në Berlin

Balla: Vajte fshehurazi në Bundestag kundër Shqipërisë

Kreu i grupit parlamentar të PS-së, Taulant Balla duke akuzuar opozitën për dëmtimin që po i bëjnë rrugës së integritimit të vendit ka deklaruar se në fillimjavë kryedemokrati Basha ka qenë fshehtas nëpër korridorët e Bundestagut gjerman. "Si kryetar i grupit parlamentar të mazhorancës, dua t'i ripërsëris grupit parlamentar të PD dhe LSI që betejën e përbashkët në interes të Shqipërisë për të llohuar së bashku në interes të hapjes së negociatave mund ta zhvillojmë së bashku, pavarësisht se jeni shumë vonë edhe pavarësisht ndërprerjeve të kësaj fillimjave të kryetarit të opozitës për të qenë fshehurazi në korridorët e Bundestagut gjerman. Jam shumë i sigurt që brenda Bundestagut gjerman kemi mbështetjen e nevojshme për të vijuar këtë proces në funksion të 28 qershorit, por edhe pas 28 qershorit", - tha z.Balla. Kreu i PD-së deklaroi në Kuvend se të hënën dhe të martën ndodhën për një vizitë në Berlin. "Po, kam qenë në Berlin këtë të hënë e të martë, jo në vizitë klandestine siç thonin ju, as të paguar me milionat e drogës, por i ftuar nga autoritetet më të larta gjermane për të diskutuar shqetësimin e tyre se situata politike në vend, 6 javë pas largimit të Ramës nga Berlini, jo vetëm që nuk ka shkuar drejt përmirësimit, por drejt përkëqësimit, që u lirua Saimir Tahiri dhe e njëjta skemë po ndiqet për të shpëtuar vëllezërit Xhafaj. Në këto kushte është e pamagjueshme që Bundestagu të rekomandojë hapjen e negociatave", tha z.Basha.

Spaho në Kuvend: Negociatat nuk hapen pa largimin e Xhafajt

Kreu i deputetëve të PD-së, Edmond Spaho deklaroi dje në Kuvend se negociatat nuk hapen pa largimin e Fatmir Xhafajt. Ai u shpreh se vendet e BE kanë pasur rezervë ndaj Shqipërisë. "Më saktësisht, kreu i PPE e kishte fjalën nëse nuk do të largohet ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj. "Të njëjtën histori keni pasur me ish-ministrin e Brendshëm, Saimir Tahiri. Tani po e fusni vendin në qerthull. Si në asnjë rast tjetër, në asnjë vend të BE dhe më gjerë nuk gjen një precedent të tillë që ministri, i cili supozohet të luftojë krimin e organizuar dhe drogën të ketë vëllain të dënuar për krim organizatash kriminale dhe trafik ndërkombëtar drogë. Do të dëshironim për shkak të rëndësisë së hapjes së negociatave të diskutonim me ministrin e Brendshëm dhe kryeministrin, por asnjë nuk është sot këtu", tha Spaho.

Xhepa: Banka Qendrore duhet të kishte ndërhyrë më parë për të blerë valutë

Ekspertët, pro ndërhyrjes së Bankës në treg

Kursi zyrtar i BSH: Forcohen të gjitha valutat



Buxhuku: Qeveria të ndërhyjë në politikat fiskale

Ornela Manjani

Ekspertët thonë se ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në kursin e këmbimit valutor ishte një nga politikat e duhura, e cila do të ndihmojë rritjen ekonomike të vendit, e veçanërisht sektorin prodhues. "Bën pjesë në kuadrin e masave politike që nuk rrezikojnë kuadrin e rritjes ekonomike, por e ndihmojnë rritjen ekonomike", -thotë eksperti i ekonomisë, Selami Xhepa. Por, Selami Xhepa thotë se në pikëpamjen e tij, një ndërhyrje e tillë e bankës qendrore për të blerë sasi valute duhet të ishte bërë më parë, për të shmangur rënien dramatike që pati javët e fundit. "Ndoshta në gjykimin tim mund të kishte qenë edhe më përpara për të mos lejuar një rënie aq dramatike", - thotë Xhepa. Ai sqaron se do të ishte një faktor pozitiv, nëse Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë do të zhvendoste në kohë të mëvonshme kalendarin e paketës rregulatore për deurizimin, për të mos dhënë efekte në zhvlerësimin e mëtejshëm të euros. Ulja e normës bazë të interesit në këto momente, sipas ekspertëve, do të mbështesë rritjen e konsumit e do të lehtësojë kredinë. Ata thonë se kjo masë synon të mbajë të stabilizuar nivelin e inflacionit.



Banka e Shqipërisë

NDERHYRJA
"Operacionet e blerjes së valutës do të synojnë eliminimin e tepricës së përkohshme të valutës në treg dhe frenimin e forcimit të mëtejshëm të kursit të këmbimit, forcim i cili do të dëmtonte përmeshjen e objektivit tonë për stabilitetin e çmimeve".

KURSI
Pothuajse të gjitha valutat janë forcur sot në tregun e brendshëm të këmbimit valutor, sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë. Një euro u këmbye sot me 125.5 lekë,

me një rritje prej 0.83 lekë në krahasim me ditën e mëparshme. Kjo është rritja e dytë më e madhe ditore për gjatë këtij viti. Dollari u rrit lehtë me 0.02 lekë, paundi me 0.41 lekë dhe franga me 0.57 lekë. Ky është niveli më lartë i euros në tregun vendas, që

nga data 1 qershor. Ndikimin kryesor në këtë rritje e ka ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë në tregun e brendshëm valutor përmes blerjes së valutës me qëllim frenimin e rënies së euros, që sipas bankës, ndonëse ishte e ndikuar nga faktorë

normës bazë të interesit. Gjithashtu, ato do të ndihmojnë tregun për të gjetur çmimin e drejtë të këmbimit të lekur kundrejt valutave, në linjë me raportet e qëndrueshme dhe afatgjatë të kërkesës dhe ofertës për të", tha guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Gent Sejko, në një konferencë për shtyp të dy ditëve më parë. Megjithatë, ekspertët e tregut valutor pohojnë se ndërhyrja e Bankës së Shqipërisë nuk pritet të ndikojë në rritje të ndjeshme të euros, pasi jemi në stinën e verës dhe prurjet valutore pritet të shtohen si nga emigrantët, ashtu edhe nga turistët. Nga ana tjetër, KESH sapo ka disbursuar një kredi prej 118 milionë eurosh, që është pjesë e një huaje prej 218 milionë eurosh nga BERZH, e cila pritet të konvertohet në mënyrë të kontrolluar me këste përgjatë ditëve në zhvillim, në mënyrë që të minimizohet efekti në kursin e këmbimit. Ekspertët pohojnë se euro pritet të stabilizohet në një ekuilibër të ri të ulët, por ky nivel ka përgjithësisht efekte pozitive për ekonominë, pasi rrit fuqinë relative blerëse.

Konfindustria vlerëson se politika fiskale e vendit për vitin 2019 duhet të kalojë në sistemin e taksës së sheshtë dhe me kah ulës të ngarkesës për qytetarët dhe bizneset e tregut të lirë. Në sa më sipër, vendimmarrja politike shqiptare duhet të ndjekë me vëmendje dhe strategjinë e qeverisë së re të Italisë, për zbatimin e taksës së sheshtë/flat tax për qytetarët dhe bizneset. Ndryshimet thelbësore të politikës fiskale të Italisë si partneri kryesor tregtar do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimet ekonomike në Shqipëri. Konfindustria vlerëson se politika e deritashme e taksave përpjesëtimore dhe ngarkesës fiskale tërësore në rritje nuk ka qenë e suksesshme. Rritja mesatare vjetore e PPB në më pak se 2.5% në 5 vitet e fundit, borxhi publik që nuk po shënon rënie nga niveli i 72% të PPB, informaliteti i lartë shprehur edhe në zhvlerësimin e fortë të panatyrshëm prej mbi 8% të euros kundrejt lekur, vendi i fundit në rajon për tërheqje e investimeve të huaja, emigracioni i shtuar dhe goditja e mirëqenies së shtresës së mesme etj., janë tregues të qartë të nevojës për ndryshime thelbësore të politikave ekonomike dhe fiskale të vendit.

Gjatësia totale e rrugëve të kontratës B 286.00 km

KESH merr transhin e parë prej 118 milionë euro të kredisë së BERZH

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) ka marrë ditët e fundit transhin e parë prej 118 milionë eurosh të një kredie prej 218 milionë eurosh të marrë nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH). Kredia e BERZH ishte miratuar që në qershor 2016 me synim ristrukturimin e borxheve të vjetra. Disbursimi i kredisë u zgjat në kohë, pasi banka kishte vënë kushte për kryerjen e reformave ligjore dhe rregulatore në sektorin e energjisë. Në prill të këtij viti, ministri i Energjisë, Damian Gjiknuri njoftoi se Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim njoftoi zyrtarisht plotësimin e të gjitha kushteve nga pala

shqiptare për bërjen efektive të marrëveshjes së kredisë. Agron Hetoja, drejtor i KESH, tha për "Monitor" se kësti i dytë i kredisë prej 100 milionë eurosh mund të disbursohet pranverën e vitit të ardhshëm, pasi duhet të plotësohen disa kushte për konsolidimin e sektorit energjetik, për të cilat do të kërkohet edhe pak kohë. Të ardhurat e kredisë do të përdoren për të rifinancuar dhe zgjatur overdraftet të garantuara me afat të shkurtër, të cilat KESH i ka marrë në bankat komerciale, si nevojë emergjente dhe të cilat kërkojnë miratimin vjetor, ka bërë të ditur BERZH në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes. Sipas marrëveshjes, KESH përmes kësaj huaje synon ristrukturimin e borxheve, optimizimin e shpenzimeve dhe përmirësimin e bilancit. Sipas relacionit, ai synon shlyerjen e borxhit të shtrënjtë afatshkurtër ndaj bankave tregtare vendëse, nëpërmjet një huaje afatgjatë, shumë më të lirë nga institucionet financiare ndërkombëtare, duke krijuar kështu mundësinë e çlirimit vit pas viti të buxhetit të shtetit nga garancitë qeveritare që ka dhënë për KESH-in (pagesat vjetore të principalit do të shkojnë për reduktimin e vullmit të garancive qeveritare).



Ndërhyrjet në rrugë, ARRSH: Gati kontrata e mirëmbajtjes për 622 km, ja qarqet

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka publikuar Planin e Menaxhimit Social dhe Mjedisor për akset rrugore në qarkun e Tiranës, Dibrës, Shkodrës dhe Kukësit, që përfshin të gjitha punët fizike, aktivitetet dhe shërbimet e nevojshme për t'i sjellë rrugët në nivelin e shërbimit të kërkuar dhe për t'i mirëmbajtur e menaxhuar. Në total janë 14 akse, ku parashikohet të ndërhyhet në tri kategori kryesore, ku bie në sy autostrada Tiranë-Durrës, Durrës-Fier, Shkodër-Kukës apo Lezhë-Shëngjin. Objektivat kryesorë të kontratave lidhen me rritjen e efikasitetit dhe efektivitetit me të cilin kryhet menaxhimi dhe mirëmbajtja, maksimizimi i vlerës së parave që shpenzohen për zhvillimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit rrugor si dhe përmirësimin e gjendjes dhe sigurinë e rrjetit rrugor në dobi të përdoruesve të tij. Në total janë rreth 622 km rrugë që pritet të jenë objekt i këtyre kontratave, vlera e të cilave nuk është përcaktuar ende. Kjo në ndryshim nga plani i menaxhimit për rajonin

AKSET RRUGORE KU DO TË NDRËHYHET	
Qarqet Shkodër dhe Kukës	
Tiranë - Han i Hotit	77,88 km
Shkodër - Kukës	138,41 km
K/Han i Hotit - Tamarë	32,60 km
Lezhë - Shëngjin	6,10 km
Ura e Bunës - Muriqan	13,9 km
Melgushë (K/Rr.Nr.1) - Mjeddë	7,10 km
Gjatësia totale e rrugëve të kontratës A	336,45 km
AKSET RRUGORE KU DO TË NDRËHYHET	
Qarqet Tiranë dhe Dibër	
Tiranë - Han i Hotit	54,55 km
Tiranë - Durrës (autostrada)	32,50 km
Durrës - Fier	34,20 km
Milot - Skuraj - Peshkopi	117,90 km
K/Rr.Nr.6 - Dogana Blladë	3,35 km
6 Vorë - K/Rinas - F.Krujë	11,50 km
Kryqëzimi Rinas - Rinas - Qafë Kashar	9,00 km
Maminas-Hamallaj-Shën Pjetër	23,00 km

jugor Vlorë-Gjirokastrë, e cila në total kap vlerën e 13.7 milionë euro. Financimi i këtyre kontratave do të bëhet nga Banka Botërore, ndërsa kontratat do të ketë një kohëzgjatje prej 5 vitesh.

Autori Qemal Sela në polici: Vrava 2 grabitës. Dëshmitarët: Pamë tmerr me sy!

Tronditet Dibra, djali emigrant ekzekuton prindërit me breshëri kallashnikovi

26-vjeçari qëlloi nënën dhe babain pak orë pasi u kthye nga Anglia. Shkak, sherri për hotelin te "Llixhat"

Enver Doçi

DIBËR

Krimi brenda familjes tronditi Peshkopinë. Një 26-vjeçar i sapo kthyer nga Anglia ka zbratur një karikator kallashnikovi mbi prindërit e tij, duke i lënë të vdekur në vend. Vetëm pak minuta më pas, i riu Qemal Sela që shkaktoi tmerr dhe panik tek banorët e këtij qyteti përfundoi në pranga. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së Qarkut të Dibrës bënë me dije se ngjarja e rëndë ku mbetën të vrarë Flamur dhe Zeqimete Sela, përkatësisht 55 dhe 50 vjeç ndodhi mesditën e djeshme (rreth orës 12:25) në lagjen "Llixha". Mësohet se bashkëshortët Sela u ekzekutuan nga djali i tyre emigrant në katin e parë të ndërtesës 4 katëshe, i cili ishte kthyer në hotel që shërben për personat që frekuentojnë llixhat e Peshkopisë. Viktimat ishin pronarë të hotelit, ndërsa shfrytëzonin si banesë katin e parë. Menjëherë pas ngjarjes së rëndë, policia ka nisur hetimet. Burime për "Gazeta Shqiptare" pohuan se dyshohet që ngjarja ka ndodhur pas një shërri mes 26-vjeçarit dhe prindërve për paratë që ai kishte sjellë nga Anglia. I riu Qemal Sela ka akuzuar familjarët se i kanë prishur lekët që kishte dërguar gjatë 7 viteve emigracion. Ndërkohë, dyshohet që autori i krimit të dyfishtë të jetë me probleme mendore. Të afërm të vrasësit kanë deklaruar se ai ka qenë i shtruar për 3 muaj në një spital psikiatrik në Angli. Gjatë marrjes në pyetje, Qemal Sela ka folur përçart, duke e thënë: Vrava dy grabitës. Ata që qëlluan nuk janë prindërit e mi!

VRASJA

Pak orë pas kthimit nga Anglia dhe konkretisht paraditen e djeshme, Qemal Sela bashkë me vëllain më të madh (28-vjeçar) dolën për të bërë xhiro në qytetin e Peshkopisë. Ndërsa, motra e tij 12-vjeçare ishte në shkollë. Teksa ishin duke shëtitur, ai i ka thënë vëllait se do të kthehej në banesë. Sapo ka shkuar në shtëpi, një ndërtesë 4 katëshe që shërben si hotel për personat që frekuentonin llixhat e këtij qyteti ai ka marrë kallashnikovin me dy karikatorë fishekë. 26-vjeçari ka qëlluar me breshëri të atin, Flamurin në katin e parë duke e lënë të vdekur në vend. Pastaj ka qëlluar për vdekje dhe nënën, Zeqimeten. Mësohet se ai ka zbratur gjithë karikatorin me plumba mbi prindërit (i ka mbetur vetëm një fishek pa shkrepur). Na atë moment, pranë hotelit në lagjen "Llixha" ishte një patrullë policie, e cila sapo ka dëgjuar



Autori i krimit të dyfishtë, Qemal Sela



Hotelin në lagjen "Llixha" ku ndodhi vrasja



krimat e armës ka ndërhyrë. Ata kanë parë agresorin me armë në dorë dhe e kanë urdhëruar të ulë armën. I riu është bindur dhe nuk ka bërë rezistencë. Sapo ka hipur në makinën e policisë, ai u ka thënë policëve që po e shoqëronin për në komisarjat. Ndizini dritat. Ndizini sirenat dhe bjerini borisë që njerëzit të hapin rrugën. E ndërsa, 26-vjeçari është prangosur, grupi hetimor ka shkuar në vendngjarje dhe ka nisur hetimet.

HETIMET

Burime pranë grupit hetimor thanë se dyshohet që autori i krimit të dyfishtë i ka vrarë prindërit për paratë që ka sjellë nga emigracioni. "Para 7 vitesh, ndërtesa ku ndodhi ngjarja ka qenë një katëshe. Nga lekët që ka dërguar djali emigrant në Angli, ndërtesa është bërë 4 katëshe. Kati i parë përdorej si banesë nga familja e tij, nëna, babai, vëllai dhe motra. Kurse, 3 katet e tjera përdoren për personat që frekuentojnë llixhat e Peshkopisë. Qemal Sela, dy-

shohet të ketë akuzuar prindërit se i kanë shpenzuar apo fshehur paratë që ai ka dërguar nga Anglia". Të njëjtat burime pohuan se

"U tronditëm tejet nga ajo që ndodhi. Pamë tmerr me sy, kur dy pronarët e hotelit u qëlluan për vdekje nga djali tyre. Falë Zotit, ndërhyri në kohë policia, pasi mund të kishte ndodhur hataja", thanë disa dëshmitarë. "Gazeta Shqiptare" kontaktoi me disa kosovarë, të cilët kishin shkuar për kurim në llixhat e këtij qyteti. "Kur dëgjuam breshërinë e armës u tmerruam. Për një moment na u kujtua koha e luftës në Kosovë me serbët", -u shprehën ata.

KOSOVARËT

"VRASËS ME PAGESË"

Emigranti 26-vjeçar Qemal Sela, i cili ekzekutoi dje me breshëri kallashnikovi prindërit pas një konflikti për paratë e hotelit në lagjen "Llixha", njëjërën prej fotove në faqen e tij në "Facebook" e shoqëronte me një status ku shkruhej: "vrasës me pagesë"

vëllai i autorit ka ndërtuar një vilë afro 300 metra larg banesës ku jetonte me prindërit dhe motrën e mir, të cilën e përdorte për

personat që frekuentojnë llixhat e Peshkopisë. Por, burimet nga policia e Dibrës janë kontradiktore. Burime zyrtare nga ky dikaster de-

klaruan se dyshohet që 26-vjeçari vuan nga probleme të shëndetit mendor dhe se e ka kryer krimin e dyfishtë në kushtet e tronditjes psikologjike. Në të njëjtën linjë janë dhe familjarët dhe të afërmit e di viktimave, të cilët janë shprehur se Qemali ka qenë tre muaj i shtruar në një spital psikiatrik në Angli. Ndërkaq, fakti që i riu i armatosur me kallashnikov nuk ka qëlluar mbi policët apo personat të tjerë që ndodheshin para hotelit hedh poshtë dyshimin. Do jetë ekspertiza që do të hedhë dritë nëse emigranti është i sëmurë mendor apo jo.

DËSHMITARËT

Vrasja e dy pronarëve të hotelit ka shokuar personat që ndodheshin jashtë ndërtesës dhe që kishin shkuar për kurim në llixhat e Peshkopisë. "U tronditëm tejet nga ajo që ndodhi. Pamë tmerr me sy, kur dy pronarët e hotelit u qëlluan për vdekje nga djali tyre. Falë Zotit, ndërhyri në kohë policia, pasi mund të kishte ndodhur hataja", thanë disa dëshmitarë. "Gazeta Shqiptare" kontaktoi me disa kosovarë, të cilët kishin shkuar për kurim në llixhat e këtij qyteti. "Kur dëgjuam breshërinë e armës u tmerruam. Për një moment na u kujtua koha e luftës në Kosovë me serbët", -u shprehën ata.

Plagosën dhe i vunë tritol një 63-vjeçari, pranga porositesit dhe dy bashkëpunëtorëve

KURBIN - Policia e Kurbinut ka zbardhur dy ngjarje kriminale të ndodhura në muajt korrik dhe gusht të vitit 2017 ku 63-vjeçarit Ndue Kola iu bë atentat duke e plagosur me armë dhe një tjetër duke i vendosur tritol makinës së tij. Pas hetimeve intensive, blutë kanë arritur të identifikojnë autorin e këtyre dy ngjarjeve Fran Gjokën, 57 vjeç, lindur në Mirditë dhe banues në Tiranë, i cili dyshohet si organizator dhe porositesit. Tri ditë më parë, ndaj tij është vendosur masa "arrest me burg" për veprat penale: "Vrasje me paramendim e mbetur në tentativë" dhe "Shkatërrim

prone me eksploziv", kryer në bashkëpunim. Sipas hetuesve të çështjes, motivi i këtyre ngjarjeve dyshohet një konflikt i ndodhur që në vitin 1997 në fshatin Fan të Mirditës, i cili ka agravuar në përdorimin e armëve të zjarrit duke mbetur të vrarë dy shtetas dhe plagosur shtetas Fran Gjoka dhe një shtetas tjetër. Për këtë ngjarje, 63-vjeçari Ndue Kola u dënua për vrasje. Gjithashtu, janë ndaluar edhe dy vajza të reja, A.I. 23 vjeç dhe I.K. 20 vjeç. Edhe ndaj tyre, gjykata e Kurbinut ka caktuar masën e sigurisë: "Arrest me burg" për veprat penale: "Falsifikimi i dokumenteve" dhe "Shtjiza e paautorizuar e kartave SIM".



Dy vajzat kanë falsifikuar dokumentet duke pajisur me karta SIM celulari autorët e dyshuar të këtyre ngjarjeve, shtetasin Fran Gjoka dhe ekzekutorin. Vazhdojnë hetimet për dokumentimin e plotë të ngjarjes për identifikimin e ekzekutorit të ngjarjeve dhe kapjen e vendosjen e tij para përgjegjësisë ligjore. Gjithashtu, në cilësimin e provës materiale është sekuestruar mjeti tip BMW X5 në pronësi të Fran Gjokës.

Shpërthimi në oborrin e banesës së ish-shefit të komisariatit të Shkodrës, për hesape të vjetra

Sulmohet me granata banesa e ish-deputetit të PD-së

Shyqyri Çela u kthye nga SHBA para një muaji: S'kam konflikte me askënd

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Banesa e ish-deputetit dhe ish-shefit të komisariatit të Shkodrës, Shyqyri Çela është sulmuar me dy granata dore. Ngjarja ka ndodhur rreth orës 03:00 të mëngjesit të djeshëm në lagjen "Partizani" të qytetit verior. Burime zyrtare nga Drejtoria e Policisë së këtij qarku bënë me dije se vetëm njëra nga granatat e hedhur në oborrin e shtëpisë së Çelës ka shpërthyer, duke shkaktuar vetëm dëme materiale (plasaritje e xhamave). Mësohet se në momentin që ndodhi shpërthimi, në banesë ka qenë vetëm ish-deputeti Çela, i cili është kthyer nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës një muaj më parë, ku jeton me familjen. Menjëherë në vendngjarje ka mbërritur policia, e cila ka nisur hetimet për zbardhjen e ngjarjes.

SULMI
Në oborrin e banesës së ish-deputetit Shyqyri Çela, ekspertët kanë konstatuar



PARALAJMËRIMI

Edhe pse banesa e Shyqyri Çelës ndodhet në fund të një rrugice dytësore dhe ka një derë të madhe e mure të larta bashkë me një rrjetë teli mbi mure, sërish autori/ët ia kanë dalë që të hedhin 2 granatat brenda në oborr. Me shumë se për të bërë dëm, kjo nga vetë Çela sipas burimeve pranë familjes, por edhe dyshimet që ka policia është një sinjal ose paralajmërim ndaj 63-vjeçarit.

se janë hedhur dy granata, ku njëra prej tyre u gjet e paspërthyer. Nga kjo ngjarje ende forcat e policisë nuk kanë ndonjë autor të dyshuar, ndërsa po punohet për identifikimin dhe më pas arrestimin e tij. Edhe pse banesa e Shyqyri Çelës ndodhet në fund të një rrugice dytësore dhe ka një derë të madhe e mure të larta bashkë me

një rrjetë teli mbi mure, sërish autori/ët ia kanë dalë që të hedhin granatat brenda në oborr. Me shumë se për të bërë dëm, ky nga vetë Çela sipas burimeve pranë familjes, por edhe dyshimet që ka policia është një sinjal ose paralajmërim ndaj 63-vjeçarit. Shyqyri Çela është një emër jo i panjohur në Shkodër. Ai ka qenë një efek-

tiv policie qoftë para viteve '90-të, por edhe pas viteve '90-të. Ka vijuar që të jetë në polici duke mbajtur më pas edhe detyra të rëndësishme si shef komisariatit në policinë e Shkodrës apo detyrë të rëndësishme edhe në Peshkopi. Hedhja e granatave në oborrin e banesës dyshohet se mund të jetë për një hesap të vjetër që daton vitin 1994,

atëherë kur mbeti i vrarë shtetasi Gjovalin Çekini dhe ndër të tjerë u akuzua edhe vëllai i Çelës, Selami Çela. Në oborrin e banesës policia bën me dije se granatat e gjetura janë të llojit luftarak dhe jo artizanale, siç u mendua fillimisht nga blutë. Shkak për mos shpërthimin e njëres mendohet të jetë vjetërsia, pasi dyshohet se janë grana-

ta të para viteve '90-të. Specialistët e anti-eksploziv po merren me detajet.

DËSHMIA E SHYQYRI ÇELËS

Pas ngjarjes, blutë kanë marrë në pyetje Shyqyri Çelën, i cili ka deklaruar se nuk ka asnjë ide se përse ka ndodhur kjo ngjarje. "Unë kam ardhur nga Amerika dhe po qëndroja në shtëpinë time. Nuk e kam idenë përse ka ndodhur. Ne s'kemi konflikte me persona të ndryshëm. Nuk kam asnjë dyshim se kush mund të jenë autorët e kësaj ngjarjeje", ka thënë ish-deputeti. Megjithatë, policia po vijon hetimet dhe dyshimet kryesore janë konfliktet që ky shtetas mund të ketë pasur gjatë viteve të vështira kur ka shërbyer në Policinë e Shtetit apo gjatë kohëve po aq të vështira kur ishte deputet në parlamentin e Shqipërisë. Edhe pse u kandidua nga PD, pak kohë pasi u përzgjodh si deputet, Shyqyri Çela në gazetën "Aleanca", botim i partisë Aleanca Demokratike kritikoi Sali Berishën duke krijuar këshutë një ndasi me demokratët dhe duke qenë më pas me shumë si i pavarur.

SHKODËR - Në vitin 1992, Shyqyri Çela u përzgjodh për të qenë kandidat për deputet i Partisë Demokratike në zonën e Matit, edhe pse banonte në Shkodër. Fitoi në zgjedhjet më të kontestuar të mundshme, të cilat sollën edhe destabilitet shumë shpejt në Shqipëri. Menjëherë pas rrënujes në vitin e mbrapshtë '97-ës, Çela u largua drejt Amerikës. Pas largimit të Mithat Havarit si shef policie në Shkodër, u shënuan disa ngjarje të rënda si dëgjia e komisariatit, gjykatës së Shkodrës apo të tjera të ngjashme. Ndërsa, erdhi si drejtuues policie pikërisht Shyqyri Çela, por nuk qëndroi shumë, sepse kaosi vijoi të ishte prezent dhe u largua drejt SHBA-ve. Përpara se të zgjidhej deputet në Kuvend, vëllai i Shyqyri Çelës, Selami Çela dyshohet se pas një konflikti me shtetasin Gjovalin Çekini, ky i fundit mbeti i vrarë. Ngjarja ndodhi më 14 janar të 1994 gjatë përvjetorit të pestë të demonstratës së parë antikomuniste në Shkodër. Atë ditë po zhvillohej tubimi i parë i partisë Aleanca Demokratike në teatrin "Migjeni". Gjergj Zefi, gazetar në atë kohë, por edhe numri dy i PAD ka treguar vite më vonë në një intervistë si një prej dëshmitarëve atë ngjarje të rëndë, se si u

Pak kohë pas ngjarjes, dy vëllezërit u larguan në Amerikë

Historia e vrasjes së Gjovalin Çekinit në '94-ën, i akuzuar edhe Selami Çela, vëllai i Shyqyri Çelës



vra Gjovalin Çekini dhe se si u implikua vëllai i Shyqyri Çelës. "Në 14 janar të 1994, në përvjetorin e pestë të demonstratës së parë antikomuniste, në një atmosferë terrori, u zhvillua tubimi i parë i Aleancës Demokratike, në teatrin "Migjeni". Qindra djem të guximshëm u mblodhën sërish për të vrarë frikën. 80% e tyre ishin të njëjtët që kishin qenë në demonstratën kundër Stalinit. Në janarin e vitit '94, ata u ngritën kundër terrorit të partisë që vetë e ngritën katër vjet më parë e që ua kishin marrë peng sigurimsat. Gjovalin Çekini ishte një gavrash i lirsisë, ai nuk ishte politikan që vrasjen e tij ta konsideroj politike, por ishte një djalë i fortë, që aspironte lirinë dhe

që u bë theror i politikës. Vrasja ishte si pasojë e nervozizmit të bandave që nuk mund ta pranonin karshi-llekun që po u bëhej në mes të Shkodrës. Që pas 2 prillit të '91-shit, ishte hera e parë që në atë qytet flitej në publik kundër "sulltanit" të tyre, Sali Berishës. Vëllai i Shyqyri Çelës ishte i pirë në atë takim, natyrisht i shtyrë nga sigurimsat, shokët e tij, dhe u përdor në atë vrasje. Ai u përplas me 'gavroshët', të cilët i dhanë një mësim të mirë. Por të gjithë antimitingashët kishin ardhur të armatosur. Ai nxori pistoletën, por vrasjen e bëri një person tjetër, me emrin Gjovalin Bari, një bandit i pushtetit, krahu i armatosur i Ali Kazazit dhe i Ali Spahisë, në atë

kohë njerëzit që kishin uzurpuar jetën politike të qytetit. Qenia vëllai i Shyqyriut bëri që gjërat të precipitonin në rrjedhën e strukturave të Sigurimit të Shtetit. Shyqyri me Preçin (Zogajin) gatuan një corbë, nga e cila asnjëri nuk u dënua dhe gjaku i Gjovalinit u shit, siç ndodh rëndom në precedentë të tillë me koperturë politike", ka pohuar Gjergj Zefi. Selami Çela u akuzua dhe për pak kohë qëndroi në burg, por arriti që të dalë shpejt dhe pas pak kohësh u largua drejt Amerikës. Të njëjtën gjë bëri edhe vëllai i tij, Shyqyri Çela pasi kishte qenë efektivi, deputet dhe shef policie. Në atë kohë u ngrit edhe një grup parlamentar për çështjen "Çekini", por nuk u arrit asnjëherë që kjo ngjarje të zbardhet e plotë. Pak kohë pas vrasjes, vëllai i Çekinit u gjet i vrarur në banesë, ndërsa arsyja e kësaj ngjarjeje të dytë që pasi nuk dihet ende as sot, ndërsa zyrtarisht policia deklaronte në atë kohë se ishte një vetëvarje.

Episod në librin "Larg dhe mes njerëzve"

Liri Lubonja: Si na kërcënoi ish-shef Shyqi mua dhe Todin

SHKODËR - Emri i Shyqyri Çelës gjendet edhe në librin e Liri Lubonjës me titull "Larg dhe mes njerëzve". Gruaja e ish-drejtorit në RTSH, Todi Lubonja, një intelektuale e njohur në Shqipëri, në faqet 284-285 në librin e saj memoristik tregon kur po shtëtise me bashkëshortin një episod me Shyqyri Çelën. "...Një pasdite, Todi dhe unë, me një bidon plastik pesë litërsh, u nisëm për fat, por më kot. Duke menduar se ai mund të na buzëqeshte në Torovicë, lamë rrugën rurale dhe dolëm në asfalt, në nacionalen. As që na kishte shkuar nëpër mend ai caku, kufiri ku duhej të shkonim. Nuk arritëm të hidhnim asnjë hap. Si për dreq, një motor që po udhëtonte me shpejtësi drejt Shkodrës, ndaloi. Në të ishte Shyqi, zv.shefi. Me atë trupin e tij të bëshëm, hapin karakteristik që u jepte postit dhe peshakëtyre individëve, eci drejt nesh. "Pse keni dalë këtu, a e dini se nuk u lejohet?" foli rëndë, ashtu siç ia kërkonte funksioni që kishte. I thamë se ishte errësirë dhe se... por atij nuk i duheshin hallet tona, ndaj po me ato tone lëshoi kërcënimin: "A e dini se për këtë shkelje shkonim në burg? Todi, i zemëruar, ia ktheu: "Nuk më tremb më burgu mua, sepse prej andej po vij". Disa çaste heshtje. Shyqi nuk e zgjati. I hipi motorit dhe u nis. Ne u kthyem në kamp me bidon bosh. Ndoshta këtë episod nuk do ta shkruaja. Do të radhite me dhjetëra e dhjetëra të tjerë të të gjithë shefave, inspektorëve, operativëve të Degës së Brendshme, me të cilët patëm të bënim ato shtatëmbëdhjetë vjet. Porse me Shyqin ndodhi ndryshe, një gjë e papritur, e habitshme për mua që vazhdoja me atë naivitetin tim të pashërueshëm. Duke lexuar listën e kandidatëve për deputetë të Partisë Demokratike, ndër ata të Shkodrës, lexova: Shyqyri Çela. I zgurdullova sytë, e rilexova. "Nuk mund të jetë ai", mendova. Dikush tjetër ka po atë emër, mbiemër. Por jo, ishte ai, Shyqi ynë që u bë deputet i parlamentit demokratik të Shqipërisë".



Ambasada Amerikane

Ekspertët: Si të aplikoni për të udhëtuar në "tokën e premtuar", dokumentacioni

Vizat turistike në SHBA, ja sa muaj duhet të qëndroni

Ambasada: Kujdes, nuk mund të punoni

Voltiza Duro

Të gjithë personat që kanë marrë një vizë turistike për të udhëtuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës duhet të kenë kujdes që të mos qëndrojnë më tepër se 6 muaj brenda një viti kohor. Ditën e djeshme, ambasada amerikane në Tiranë, nëpërmjet një njoftimi të publikuar në faqen e saj zyrtare bën me dije se duhen ndjekur rregullat me përpikmëri, në të kundërtë qytetarët mund të penalizohen. "Kini parasysh që vizat turistike ka për qëllim një qëndrim për një kohë të shkurtër në SHBA - vizat turistike nuk është për të jetuar në SHBA dhe as për të punuar atje. Përndryshe, ju mund të gjendeni i papranueshëm sipas ligjit të imigracionit", - theksojnë ekspertët e ambasadës. Zyrtarët e kufirit të Shteteve të Bashkuara përcaktojnë se sa kohë mund të qëndrojnë aplikantët në Shtetet e Bashkuara e për shumicën e mbajtësve të vizave të vizitorit (B1/B2), koha maksimale e qëndrimit është në përgjithësi gjashtë muaj në një vit kohor. Studentët, vizitorët e programeve të shkëmbimit dhe punëtorët e përkohshëm janë në përgjithësi të pranuar për kohëzgjatjen e statusit (e shkruar "d/s" në pasaportë). Pavarësisht nga kjo, për të shmangur në të ardhmen problemet me vizën apo me hyrjen në Shtetet e Bashkuara, qëllimi dhe koha e qëndrimit në Shtetet e Bashkuara duhet të jetë në përputhje me çfarë individi ka thënë në aplikimin për vizë. "Nëse oficeri i imigracionit ngre dyshime që qëllimi i juaj

DOKUMENTACIONI

Për vizë vizitorit B1/B2 aplikanti duhet të paraqesë:

- Pasaportën.
- Një kopje të printuar të fletës së konfirmimit të aplikimit elektronik DS-160.
- Një foto me ngjyra 5cm X 5cm të nxjerrë kohët e fundit, e cila duhet të përmbushë të gjitha kërkesat.
- Nuk nevojiten dokumente të tjera.
- Nuk nevojitet një ftesë.
- Mos sillni letra nga banka dhe dokumente të tjera që nuk janë kërkuar.
- Secili aplikant i vizës turistike duhet të dëshmojë që nuk është një imigrant i mundshëm, që ka lidhje të forta ekonomike e familjare me Shqipërinë dhe që do të kthehet sërish pas një qëndrimi të shkurtër në SHBA.

i vizitës nuk është turist, por për punë, juve mund t'ju revokohet viza. Dhe keni parasysh që keqpërdorimi i vizës ndikon edhe tek bashkëkombësit tuaj. Qëndrimi jashtë statusit në SHBA është shkelje e ligjit të imigracionit të SHBA-ve dhe mund t'ju bëjë ju të papranueshëm për vizë në të ardhmen", - nënvizon ambasada.

APLIKIMI

Për vizë vizitorit B1/B2 aplikanti duhet të paraqesë vetëm pasaportën, një kopje të printuar të fletës së konfirmimit të aplikimit elektronik DS-160 dhe një foto me ngjyra 5cm X 5cm të nxjerrë kohët e fundit, e cila duhet të përmbushë të gjitha kërkesat. Nuk nevojiten dokumente të tjera e nuk nevojitet një ftesë. "Ju lutemi mos sillni letra nga banka dhe dokumente të tjera që nuk janë kërkuar. Ato nuk do të shqyrtohen. Vetëm oficeri konsullor që ju merr në intervistë pasi të ketë shqyrtuar çështjen tuaj dhe t'ju ketë

intervistuar, do të marrë vendimin nëse gjendeni ose jo i kualifikueshëm", - bëjnë me dije ekspertët e ambasadës. Gjithsesi, secili aplikant i vizës turistike duhet të tejkalojë prezumimin e qëllimit imigrues të aplikantit, pra që të dëshmojë që nuk është një imigrant i mundshëm, që ka lidhje të forta ekonomike e familjare me Shqipërinë dhe që do të kthehet sërish pas një qëndrimi të shkurtër në SHBA. Në faqen zyrtare në "Facebook", ambasada amerikane shpjegon për aplikantët se nëse arrijnë të përzgjidhen....., tarifa e aplikimit për vizë për një person është 330 dollarë, vizita mjekësore shkon 205 dollarë dhe pasi kandidati ka marrë vizën, 220 dollarë është shuma që duhet paguar për lëshimin e "Green Card". Por gjithashtu bëhet me dije se këto tarifa mund të pësojnë ndryshime që nuk varen nga ambasada. Vetëm aplikimi për lotarinë është falas.

REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (CONSULTING COMPANY)

ALBANIA
CITIZEN - CENTRIC SERVICE DELIVERY PROJECT
Loan Agreement Project ID No. 8521

Posted 07.06.2018

Assignment Title: **Conducting the Midterm Assessment – Household Survey**

Ref. No: **ALB-8521/CS/CQ/3.11.01**

Under the Innovative Good Governance priority, launched in April 2014, the Program "Innovation against Corruption: Building a Citizen Centric Service Delivery Model in Albania continues under the supervision of the Deputy Prime Minister's Office. The program entails a multilayered reform that focuses on key administrative central government public services to reduce the time and burden for citizens and businesses and improve service delivery quality, transparency and efficiency by using innovative solutions and information technologies. Its key pillars are (i) the establishment and management of an integrated nationwide model of service delivery whereby, the front office is focused on the relation with the public and is separated from back office processing, including the implementation of the one-stop-shop and in-one-place approach of the Citizen Service Center; (ii) service provision standardization, simplification through business process re-engineering and digitization, with a focus on online services; and (iii) citizen feedback and performance monitoring on service delivery for ongoing improvement.

ADISA has taken several steps by first standardizing the information on public services and making such information available in multiple platforms, both digital and non-digital in order to reach all population categories. Such platforms include a dedicated line 118 00 (Call Center service), operational for inbound calls since October 2016, the One Stop Shop Centers where a dedicated desk is set for providing information to anyone who visit them, the e-Albania portal and ADISA's website.

A baseline assessment survey was conducted in the first half of 2016, producing baseline data on several indicators, in order to measure progress toward project's objectives.

As part of the effort to monitor the effectiveness of these interventions, ADISA is seeking the services of a firm/Consultant to conduct a midterm assessment to measure project progress. It consists of conducting a nationally representative household survey, intended to yield data on citizen access to public services, citizen satisfaction with public services, use of e-government, and channels for service delivery and information, etc. The information collected through the HH survey will supply data on specific project indicators regarding Access to administrative services in Albania, particularly the access to services of the vulnerable groups (including Roma), poor, female, etc.,

The Project Management Unit now invite eligible "Consultant" to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The Consultant shall possess and be able to prove the following qualifications, experience, skills and competencies:

- No less than 10 (ten) years of general experience in surveying is required, with special reference to nationwide household surveys.
- At least 2 similar contracts successfully carried out within the last 5 (five) years with certificates of satisfaction issued by the employers.
- Key staff with necessary qualifications and experience to run and manage and the assigned tasks. These include:
 - Team Leader, who plans, supervises and manages the entire assignment, both the HH survey, with the assistance of the field and data managers and data analysts. S/he is responsible for the reporting to the beneficiary. Requirements comprise at least ten years of experience in managing and conducting related development assessment surveys, evaluations, and field research, including significant experience conducting large-scale, complex, mixed-method studies, data analyses, and producing high quality written reports. Should possess degree in management, economics, or other relevant field, and specific training/experience in survey management and data analysis.
 - 1 Project coordinator, responsible for daily coordination and management of project activities, resources, equipment and information. He/she is the liaison between the team leader and the rest of the staff. Project coordinator must possess demonstrated experience as project coordinator, with proven experience in managing large scale quantitative surveys. Should possess degree in management, economics, or other relevant field, and specific training/experience in survey management.
 - 3 Field Managers responsible for training of field staff in charge for carrying out the face to face household assessment, which plan, supervise and manage the field work. The Field Managers must have experience in managing field work of large-scale household surveys of over 1000 households; have degree in management, or other relevant field, and specific training in survey management. They must be familiar with the use of the CAPI.
 - 1 Data Analysts/manager, who plans, supervises and manages data entry, error checking, processing and consolidation of data; has solid skills in both quantitative and qualitative analysis including professional and frequent application of quantitative analysis software such as SPSS, STATA, or equivalent applications. The data analyst/manager must have experience in managing data entry of large-scale household surveys of over 1000 households; degree in statistics or other relevant discipline; specific training in household survey management and data analysis, and specific training and experience in using CAPI.

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers (January 2011 edition, revised July 2014) ("Consultant Guidelines"), setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

The Consultant will be selected in accordance with Consultant Qualifications method set out in the Consultant Guidelines.

Further information can be obtained at the address below during office hours from 08:00 to 16:00, Mondays to Thursdays, and from 08:00 to 14:00 on Fridays

The notification is posted on the website of the Agency for the Delivery of Integrated Services in Albania (ADISA): www.adisa.gov.al.

Expressions of interest (CVs, Letter of Interest and documentary evidence for fulfilling the qualifications) must be delivered in a written form to the address below in person, or by mail, or by e-mail by **June 21, 2018, at 12.00 local time**

Project Management Unit
Blvd: Zhan d'Ark,
Ish shtepia e oficerave, Kati V-te
Tirana, Albania
E-mail: roland.larashi@inovacioni.gov.al; and ccsdprojectalbania@gmail.com

Drejtoresha Ina Xhepa: Ky institucion i arsimit të lartë, ndër më prestigjiozët në vend

BE financon projekt bashkëpunimin me "Luarasin"

Studentët, trajnim 3 ditor dhe certifikata nga Qendra Europiane

Voltiza Duro

Kolegji Universitar "Luarasi" ka zhvilluar ditën e djeshme trajnimin "Standardet e procesit të rregullt ligjor si kusht në funksionimin e shtetit të së drejtës". Qendra Europiane ka përzgjedhur Fakultetin e Drejtësisë të këtij institucioni elitare të arsimit të lartë duke vlerësuar si shumë të rëndësishëm procesin e promovimit të standardëve të lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri. Ky trajnim tri ditor vjen si pjesë e pandarë e konsolidimit të shtetit të së drejtës, e ka në fokus disa parime kryesore si aksesin në gjykatë, kohëzgjatja e procedimeve, pavarësia dhe paanësia e gjyqësorit etj. Ndërkohë drejtoresha ekzekutive e Qendrës Europiane, PhD. Ina Xhepa diskutoi me studentët mbi mënyrën e funksionimit të gjykatës dhe procedurat që duhen ndjekur nga shtetasit që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Gjithash-



Gjatë trajnimit në Kolegjin Universitar "Luarasi"

CERTIFIKIMI NGA BE

Rreth 30 studentët të Luarasis, në fund të trajnimit do të pajisen me një certifikatë shumë të rëndësishme që lëshohet nga Qendra Europiane për një projekt të financuar nga Bashkimi Europian. Ky trajnim ka si synim të përmirësimit dhe thellimit të njohurisë së studentëve.

tu, Xhepa trajtoi edhe rëndësinë e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, rolin, mënyrën dhe procedurat e funksionimit të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut duke marrë raste konkrete nga jurisprudenca e kësaj gjykatë.

Ajo e vlerësoi Kolegjin Universitar "Luarasi" si një ndër universitetet më prestigjioze në vendin tonë. "Kemi përzgjedhur "Luarasin" si një ndër universitetet më prestigjioze të arsimit të lartë në Shqipëri, për të trajnuar studentët mbi të

drejtat dhe liritë themelore të njeriut", u shpreh Xhepa. Ndërkaq, sipas Dr. Dorina Gjipali, shefe e departamentit të Drejtësive Publike në Kolegjin Universitar Luarasin, i rëndësishëm është trajnimi i studentëve gjatë viteve të studimit. "Fokusohe mi nënin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për standardet e procesit të rregullt ligjor si një nen shumë i rëndësishëm për garantimin e një procesi të rregullt në 47-të vendet e Këshillit të Europës. Për fakultetin e Drejtësisë së Kolegjit Universitar Luarasin është i rëndësishëm jo vetëm formësimi në auditor i studentëve, por dhe trajnimi i tyre gjatë këtyre tri viteve akademike", tha Gjipali. Rreth 30 studentët të Luarasis, në fund të trajnimit do të pajisen me një certifikatë shumë të rëndësishme që



INA XHEPA "LUARASI, NDRË MË PRESTIGJIOZËT"

"Kemi përzgjedhur "Luarasin" si një ndër universitetet më prestigjioze të arsimit të lartë në Shqipëri, për të trajnuar studentët mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut", u shpreh PhD. Ina Xhepa, drejtoresha ekzekutive e Qendrës Europiane. Më tej, ajo diskutoi me studentët mbi mënyrën e funksionimit të gjykatës dhe procedurat që duhen ndjekur nga shtetasit që pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre. Gjithashtu, Xhepa trajtoi edhe rëndësinë e Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, duke marrë raste konkrete.



DORINA GJIPALI TRAJNIMI I STUDENTËVE, SYNIMI KRYESOR

"Fokusohe mi nënin 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për standardet e procesit të rregullt ligjor si një nen shumë i rëndësishëm për garantimin e një procesi të rregullt në 47-të vendet e Këshillit të Europës. Për fakultetin e Drejtësisë së Kolegjit Universitar Luarasin është i rëndësishëm jo vetëm formësimi në auditor i studentëve, por dhe trajnimi i tyre gjatë këtyre tri viteve akademike", tha Dr. Dorina Gjipali, shefe e departamentit "E drejta Publike" në Kolegjin Universitar Luarasin.

lëshohet nga Qendra Europiane për një projekt të financuar nga Bashkimi Europian. Ky trajnim ka si synim të përmirësimit dhe thellimit të njohurisë së studentëve të Fakultetit të Drejtësisë së Kolegjit Universitar "Luarasi", si jurist të ardhshëm mbi Standardet Europiane për të Drejtat e Njeriut. Edhe vetë studentët e Luarasis u shpre-

hën tejet të kënaqur dhe e konsideruan si tepër të vlefshëm këtë trajnim. "Ne, studentëve të vitit të parë na jep shumë mundësi të reja ky trajnim. Realisht ne i kemi studiuar dhe më parë këto tema, por tani në praktikë janë thuarja edhe më të prekshme", tha një nga studentët e Fakultetit të Drejtësisë në "Luarasi".



Njoftim i shoqërisë ALBtelecom Sh.A.

ALBtelecom njofton të gjithë abonentët e tij të telefonisë së levizshme se duke filluar nga data 16 korrik 2018, për pajtimtarët me parapagesë, do të ofrojë paketat 30 ditore Super me përfitimet si më poshtë:

Paketat Super	Super 500	Super 700	Super 1100	Super 1300	Gigastike	Super 1900
Çmimi (me TVSH)	500 Lekë	700 Lekë	1.100 Lekë	1.300 Lekë	1.300 Lekë	1.900 Lekë
Minuta Kombëtare (përfshirë rrjetet e tjera fikse)	300	200	2500	3000	400	3500
Minuta drejt rrjetit ALBtelecom Fiks	300	400	500	3000	400	3500
Minuta Ndërkombëtare				30		60
SMS drejt ALBtelecom Mobile	300	400	1000	2500	400	3000
SMS Kombëtare			500	400		300
SMS Ndërkombëtare						
Internet 3G/4G		300 MB	3 GB	5 GB	5 GB	12 GB
Internet 3G/4G+						3 GB
Përfitime të tjera					10 GB (Social & Chat)	
TV				ALBtv Mobile	ALBtv Mobile	ALBtv Mobile
Vlefshmëria	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë	30 Ditë

Paketa 30 ditore Super 1000 nuk do të ofrohet më në treg. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët e kanë këtë paketë aktive në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë ta përdorin deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së saj. Të gjithë pajtimtarët me parapagesë të cilët kanë të aktivizuar Paketën Super 500, Super 700, Super 1300 dhe Super 1900 në momentin e ndryshimit, do të vazhdojnë t'i përdorin këto paketa të pandryshuara deri në përfundimin e afatit të vlefshmërisë së tyre.

Për më shumë informacion vizitoni dyqanet tona ALBtelecom, faqen tonë zyrtare www.albtelecom.al ose telefononi Shërbimin e Klientit në 123.*



REPUBLIKA E SHQIPËRISE BANKA E SHQIPËRISE DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: **"Blerje programesh Software për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

'Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me **fond limit 3.581.600 Lekë**".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411 (ext. 4251), çdo ditë nga ora 10.00 – 13.00 nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraparakitsh pjesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme:

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: **"Blerje programesh Software për nevojat e Bankës së Shqipërisë"**

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë **04 Korrik 2018, ora 11:00**, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

KËSHILLI BASHKIAK VENDIMET

Opozita largohet nga mbledhja. Trajtim me bonus strehimi për njerëzit në nevojë

Vendimi, ja sa do të rriten pagat e edukatoreve

Ndihmë financiare për 30 familje të prekura nga dëmet natyrore

Voltiza Duro

Duke filluar nga muaji qershor, pagat e edukatoreve të çerdheve dhe kopshteve të Tiranës do të jenë më të larta, ndërsa taksa e pronës do të mbetet e pandryshuar. Këto janë disa prej vendimeve kryesore të miratuara dje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të Tiranës. Ndërkohë, opozita pasi votoi vendimet mbi ndihmën ekonomike dhe barazinë gjinore braktisi mbledhjen pasi sipas tyre 6 anëtarë kanë mandate të pavlefshme. "Ne kemi një marrëdhënie të kushtëzuar pasi që në fillim të seancës mbajmë një qëndrim. Meqenëse janë gjashtë mandate të pavlefshme, ne votojmë vetëm ndihmën ekonomike dhe barazinë gjinore. Nuk i ndoqëm diskutimet e tjera", tha për "Gazeta Shqiptare", Eltjon Halimi, këshilltar i LSI.

VENDIMET

Këshilli Bashkiak miratoi dje propozimin e Bashkisë së Tiranës për rritjen e pagës për të gjitha edukatorët, duke u dhënë një vlerësim për punën që po bëjnë për fëmijët. Kryebashkiaku Erion Veliaj tha se çerdhet e kopshteve të Tiranës ofrojnë kushte shumë më të mira, jo vetëm krahasuar me situatën para 2015-s, por edhe me pjesën dërrmuese të kopshteve të çerdheve private. "Ky është një lajm shumë i mirë për qindra edukatore të Tiranës. Tani që bashkia ka më shumë financa, mbas zjarrfikësve, kishim premtuar se do t'u rrisim pagën edukatoreve. Dua t'i falënderoj shumë për sakrificën", tha ai. Projektet "Adopto një çerdhe" dhe "Adopto një kopsht" ishin dy nga programet më të bukura, por edhe një mënyrë shumë e mirë për të treguar se prioriteti i bashkisë ishin fëmijët e Tiranës dhe gjenerata tjetër. Këshilli Bashkiak miratoi edhe vendimin për dhënie të ndihmës financiare për përbalimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme, për disa familje që banojnë në territorin administrativ të Bashkisë së Tiranës dhe nëpërmjet të cilit përfitojnë më shumë se 30 familje.



Dje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak

PAGAT E EDUKATOREVE

"Ky është një lajm shumë i mirë për qindra edukatore të Tiranës. Tani që bashkia ka më shumë financa, mbas zjarrfikësve, kishim premtuar se do t'u rrisim pagën edukatoreve. Dua t'i falënderoj shumë për sakrificën", tha Veliaj.

30

FAMILJE NDIHMË FINANCIARE

Këshilli Bashkiak miratoi edhe vendimin për dhënie të ndihmës financiare për përbalimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi të ndryshme, për disa familje që banojnë në territorin administrativ të Bashkisë së Tiranës dhe nëpërmjet të cilit përfitojnë më shumë se 30 familje.

miratuan edhe disa vendime me karakter ekonomik si: vendimi "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.59, datë 30.12.2015 të Këshillit Bashkiak "Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në qytetin e Tiranës", të ndryshuar; vendimi "Për miratimin e treguesve të realizimit të buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2017"; vendimi "Për miratimin e

Niveli i pagave për punonjësit e Qendres Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve					
Nr.	pozicioni	Kategoria/ Klasa	Grupi	Shtesa per vjetësi	Shtesa per pozicion
I	Punonjes të sistemit me page grupi -/shtesa pozicioni		1	2	3
1	Drejtor i Përgjithshëm	H-a	1	2%	115 000
2	Drejtor	II-b	1	2%	90 000
3	Përgjegjes sektori	III-a	1	2%	69 000
4	Përgjegjes sektori	III-a/1	1	2%	58 000
5	Specialist I	IIH-b	1/2	2%	50 000
6	Specialist II	IV-a	1/2/3	2%	43 000
7	Përgjegjes çerdheje	IV-a	1/2/3/4	2%	43 000
8	Edukatore	IV-b	1/2/3/4	2%	35 000
II	Punonjes të sistemit me klasa	Klasa		Shtesa per vjetësi	Paga baze
9	Kuzhinierë, kujdestare, magazinier, furnitor	VI		1%	34 500
10	Shofer	IV		1%	33 400
11	Nd/ Kuzhinier	III		1%	32 500
12	Rroje	II		1%	31 600
13	Sanitarë,guant, magaziner	I		1%	30 000

Faksimile e vendimit mbi rritjen e pagave të edukatoreve

1. Shtesa per vjetësi në punë për Lidhjen Nr. 5 per kategorine I te jepet ne masen 2% pas çdo viti pune, deri ne 25 vjet, dhe te llogaritet mbi pagën e grupit.

2. Shtesa per vjetësi në punë për Lidhjen Nr. 5 per kategorine II te jepet ne masen 1% pas çdo viti pune, deri ne 25 vjet, dhe te llogaritet mbi pagën baze.

Ne Lidhjen Nr. 5 propozohet paga e grupit, vjetërsia dhe shtesa per pozicion për nepunesit e Qendres Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve, sipas kategorive, si dhe per punetoret sipas klasave, paga baze e vjetërsia ne masen 1% pas çdo viti pune, qe llogaritet mbi pagën baze te lidhjes Nr. 5

treguesve ekonomikë dhe financiarë të Bashkisë së Tiranës dhe tavanëve përgatitorë të programit buxhetor afatmesëm për periudhën 2019-2020" apo edhe vendimi "Për disa ndryshime në vendimin nr.132, datë 21.12.2017 të Këshillit Bashkiak "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2018-2020

dhe detajimin e buxhetit të bashkisë së Tiranës për vitin 2018 (i ndryshuar)". Në mbledhjen e djeshme, Këshilli Bashkiak miratoi një sërë projektvendimesh të tjera të rëndësishme, sikurse është ai "Për trajtimin me bonus strehimi të disa familjeve në nevojë, të cilat nuk mund të përballojnë qiranë

TAKIMI

Blendi Klosi:Këtë sezon presim 35 mijë turistë

Kryetarët e bashkive të Shqipërisë dhe Danimarkës u bënë bashkë në Tiranë për të shkëmbyer eksperiencat e tyre. Ata dhanë shembuj se si zgjidhet inteligjente mund të lehtësojnë përditshmerinë e qytetarëve, duke theksuar se evitojnë edhe korrupsionin. Synimi për të përgatuar ide inovative për një qytet në shërbim të qytetarëve ka bërë bashkë kryetarët e disa bashkive të Shqipërisë, por edhe Danimarkës. Kryetari i Bashkisë së Tiranës, Erion Veliaj, listoi disa prej projekteve që kanë lehtësuar përditshmerinë e qytetarëve. "Ambicia jonë është që deri në vitin 2030 ne të kapim Kopenhagenin, pra 50% e udhëtimeve në Tiranë të ndodhin me biçikletë. Sot jemi në nivelin 6%. Para një viti ishim 3%", tha Veliaj. Ndërkohë, kryetari i Bashkisë Shkodër tha se idetë inovative evitojnë korrupsionin. "Një ndër çështjet që ne adresojmë është korrupsioni në Shqipëri. Unë mendoj që ato përgjigjet që japin, zgjidhje me marrin, janë një instrument shumë i mirë për të luftuar korrupsionin që ekziston dhe për të bërë të mundur që pushteti të shkojë tek njerëzit", u shpreh ajo. Ministri i Turizmit dhe Mjedisit, Blendi Klosi, tha se brenda këtij sezoni priten të vijjnë përmes charterave të paktën 35 mijë turistë. "Ne jemi në mbështetje të çdo ideje duke menduar gjithmonë se një Shqipëri turistike të ketë gjithnjë e më shumë zgjidhje inteligjente dhe miqësore me mjedisin. Prandaj ide të cilat vijjnë këtu për të transformuar mënyrën e funksionimit të pushtetit lokal janë gjithmonë të mirëpritura nga Ministria e Mjedisit", u shpreh Klosi. Ndërsa Ministri i Jashtëm i Danimarkës, Jens Martin Alsbirk, tha se Shqipëria po implementon shumë ide që janë aplikuar edhe në vendin e tij, por nuk përjashtoi mundësinë që edhe Danimarka të mund të mësojë nga Shqipëria.

Dosjet e viteve 1993-2008, formulari-tip për informim në lidhje me ecurinë vendimeve

Ornela Manjani

Pronarët në Korçë, ATP merr në shqyrtim 10 mijë dosje

Problematikat, procedurat për t'u njohur me ecurinë e shqyrtimit

Agjencia e Trajtimit të Pronave publikon listën me 10 mijë dosje ish-pronarësh, që janë në proces shqyrtimi nga kjo agjenci. Kërkesit janë në qarkun e Korçës. Në listën e përditësuar jepet numri i dosjes dhe data e aplikimit, gjeneralitetet e kërkesit, sipërfaqet e njohura për kompensim, dosjet për pronarët që kanë marrë vendim negativ dhe dosjet që duhet të plotësohen. Dosjet janë të viteve 1993 deri në vitin 2008. Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vënë në dispozicionin të pronarëve formularin-tip, "Informacion në lidhje me ecurinë e dosjes", i cili duhet të plotësohet dhe të dorëzohet në Agjencinë për t'u njohur me fazën në të cilën ndodhet shqyrtimi i saj. Agjencia e Trajtimit të Pronave është e detyruar që brenda 15 ditëve nga momenti i dorëzimit të kërkesës t'i kthejë përgjigje pronarit në lidhje me ecurinë e dosjes.

FORMULARI

Formulari i aplikimit për informacion në lidhje me ecurinë e dosjes është i ndarë në tri seksione. Aplikanti duhet të plotësojë gjen-

eralitet, adresën dhe të jetë i pajisur me mjet identifikimi në momentin e aplikimit. Në seksionin e dytë duhet të jetë përshkruar në mënyrë të saktë se në lidhje me çfarë kërkoh informacion pala e interesuar, në këtë rast pronari që ka aplikuar për kthim e kompensim prone. Dhe në seksionin e fundit janë të specifikuar pesë dokumentet që duhet të disponoj pronari në momentin e aplikimit.

APLIKIMI

Për t'u njohur me ecurinë e dosjes, subjekti duhet të plotësojë dhe të paraqesë dorazi ose me postë pranë ATP-së kërkesën përkatëse me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes, fotokopje të kartës së identitetit, dëshmi trashëgimie

DOKUMENTACIONI QË DUHET TË PARAQISNI

- Formulari-tip
- Fotokopje e kartës së identitetit
- Kopje vendimi nga ish-KKP/AKKP (nëse ka)
- Dokumente të tjera

dhe prokurë të posaçme. Në faqen zyrtare të ATP-së mësohet se subjekti plotëson kërkesën me shkrim për informim në lidhje me ecurinë e dosjes pranë Zyrës së Marrëdhënieve me Publikun, në 'Agjencinë'. Me pas, kërkesa i kalon zyrës së protokollit, e cila pasi e protokollon, ia dërgon të gjitha kërkesat e ardhura drejtorit të përgjithshëm. Kreu i AKKP-ës ia delegon kërkesat sek-

torit përkatës për ndjekje dhe zbatim. Me pas, sektori përkatës përgatit informacionin e kërkuar dhe njofton subjektin. Në përfundim të shqyrtimit, subjekti paraqitet pranë zyrave të ATP-së për të tërhequr shkresën e kthimit të përgjigjes në lidhje me ecurinë e dosjes ose i dërgohet me postë, sipas kërkesës. Aplikimi për kërkesën për informim mbi dosjen nuk ka kosto.

KORÇË

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
164	Pogradec	Safet		Japelli		Vërtetim Kadastral Vendim Gjyqësor S'ka Hartë
228	Pogradec	Xhevit		Liqollari		Vërtetim Kadastral Ka hartë
322	Pogradec	Fatmirë		Maxhari		Vërtetim Kadastral S'ka hartë
107	Pogradec	Tasi		Gusho		Vërtetim Kadastral S'ka hartë
370	Pogradec	Sadiq		Ahmeti		Vërtetim Kadastral S'ka hartë
147	Pogradec	Irsan		Kapa		Vërtetim Kadastral S'ka hartë
377	Pogradec	Muhamrem		Lena		Vërtetim Kadastral S'ka hartë
357	Pogradec	Nikolla		Vakos		Vërtetim Kadastral S'ka hartë
368	Pogradec	Pasko Todi Pandeli		Gjika		Vërtetim Kadastral S'ka hartë
200	Pogradec	Pembe		Maze		Vendim Gjykatë S'ka Hartë
188	Pogradec	Aldridta		Naco		Vërtetim Kadastral S'ka hartë
48	Pogradec	Thema		Ilo		Vërtetim Kadastral Ka hartë
130	Pogradec	Gafar	Sabri	Kapa		Vërtetim Kadastral Ka hartë
81	Pogradec	Selime Hevefie Sefedin		Zeqollari		Vërtetim Kadastral Ka hartë
175	Pogradec	Sulejman		Hyskollari		Vërtetim Kadastral S'ka hartë
266	Pogradec	Avdije		Zeqollari		Vërtetim Kadastral Ka hartë
167	Pogradec	Emin		Hoxha		Vërtetim Kadastral Ka hartë
161	Pogradec	Jovan		Kreste		Vërtetim i Arkivit Vendori i Rrethit Pogradec S'ka Hartë
191	Pogradec	Naami		Pere	151300	Vërtetim Kadastral S'ka hartë
106	Pogradec	Edmond		Gusho	9171	Vërtetim i Arkivit të Rrethit S'ka hartë
361	Pogradec	Piro		Shkurti	3061	Vërtetim i Arkivit të Rrethit S'ka hartë
376	Pogradec	Xhemal		Cela	114 905	Vërtetim i Arkivit të Rrethit S'ka hartë
42	Pogradec	Kastriot		Marroli	87979	Vërtetim i Arkivit të Rrethit Hartë e Seksionit të Kadastrës
46	Pogradec	Piro		Tasellari	43249	Vërtetim i Arkivit të Rrethit S'ka hartë
82	Pogradec	Vangjel		Gjorgo	38131	Vërtetim i Arkivit të Rrethit Hartë e Seksionit të Kadastrës
85	Pogradec	Nurie		Mimimi	33714	Vërtetim i Arkivit të Rrethit Ka hartë
378	Pogradec	Pëllumb		Dervishi	1441	Vërtetim i Arkivit të Rrethit Ka hartë
86	Pogradec	Garip		Dervishi	7391	Vërtetim i Arkivit të Rrethit S'ka hartë
80	Pogradec	Vasil		Berberi	736	Vërtetim i Arkivit të Rrethit Ka hartë
171	Pogradec	Jorgjie		Gusho	1524	Vërtetim i Faktit Juridik Vërtetimi i Arkivit të Rrethit S'ka hartë
354	Pogradec	Agim		Gjore	1682	Vërtetim i Arkivit të Rrethit S'ka hartë
150	Pogradec	Neki		Pupa	58721	Vërtetim i Faktit Juridik S'ka hartë
380	Pogradec	Petra		Mile	540	Vërtetim i Arkivit të Rrethit Hartë e Seksionit të Kadastrës
141	Pogradec	Moisi		Belli	64100	Ka 220 dt. 22.12.1994 KKKP-Rrethi Pogradec i është njohur pronësia për sipërfaqen 900 m2 truall në fshatin Pretushë
221	Pogradec	Agjierim		Kadilli	15000	Me Vërtetim Kadastrë Me Planvendosje
2	Pogradec	Gani		Ibi	16000	Me Vërtetim Kadastrë Nuk ka Planvendosje
382	Pogradec	Sandri		Mile	966	Me Vërtetim Kadastrë Me Planvendosje

Nr./Dosjes	Rrethi	Emri (Subjekti kërkuar)	Atesia 2	Mbiemri (Subjekti kërkuar)	Sip. E Njohur/ Mosnjohje M2	Problematika
296	Pogradec	Xhemil		Zgjani	73230	Me Vërtetim Kadastrë Me Planvendosje Sipërfaqja 11761 m2 është trajtuar më parë si truall
313	Pogradec	Tefik		Duka	58290	Me Vërtetim Kadastrë Nuk ka Planvendosje
75	Pogradec	Mersin		Ibi	62388	Me Vërtetim Kadastrë Nuk ka Planvendosje
105	Pogradec	Neim		Shkullaku	18150	Me Vërtetim Faktit Juridik Nuk ka Planvendosje
352	Pogradec	Skender		Rexhollari	51018	Me Vërtetim Faktit Juridik Nuk ka Planvendosje
225	Pogradec	Nafie		Olldashi	26629	Me Vërtetim Faktit Juridik Nuk ka Planvendosje
388	Pogradec	Nimete		Afisllari	26215	Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosje
61	Pogradec	Vasfi		Çekipi	28920	Me Vërtetim Kadastral Vendimi nuk ka Planvendosje
281	Pogradec	Ali		Fero	23605	Vërtetim i Faktit Juridik Vendimi nuk ka Planvendosje
294	Pogradec	Todi		Kopbardi	26700	Vërtetim i Faktit Juridik Nuk ka Planvendosje Sipërfaqja prej 291 m2 Trajtuar si truall
288	Pogradec	Ismail		Hoxhallari	35475	Vërtetim i Faktit Juridik Vendimi nuk ka Planvendosje
284	Pogradec	Enver		Hoxhallari	83168	Vërtetim i Faktit Juridik Vërtetim i Faktit Juridik Vendimi nuk ka Planvendosje
4	Pogradec	Behije		Cela	40960	Vërtetim i Faktit Juridik Nuk ka Planvendosje Sipërfaqja prej 2330 m2 Trajtuar më parë si Truall
57	Pogradec	Mihali		Bice	37399	Vërtetim i Faktit Juridik Nuk ka Planvendosje Sipërfaqja prej 716 m2 Trajtuar më parë si Truall
39	Pogradec	Spiro		Bicja	11638	Zbritur Sipërfaqja 2000 m2 e përfutur sipas Ligjit 7501
299	Pogradec	Xhelal		Hymettllari	20732	Vërtetim Kadastrë Vërtetim i Faktit Juridik Nuk ka Planvendosje Zbritur 6400 m2 Përfutur nga Ligji 7501
146	Pogradec	Ligor etj		Gjergji	10740	Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje
237	Pogradec	Vasil		Tasellari	14500	Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje
202	Pogradec	Niko		Naço	13480	Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje
259	Pogradec	Vera		Cela	133193	Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Zbritur 807 m2 Truall Trajtuar më Parë
262	Pogradec	Rexhep		Belli	33726	Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Zbritur 10274m2 Truall Trajtuar më Parë
263	Pogradec	Agim		Maxhari	63135	Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Zbritur Sipërfaqja 1865 m2 përfutur me Ligjim 7501
230	Pogradec	Anife		Durbaku (Gjata)	20580	Vërtetim i Faktit Juridik Nuk ka Planvendosje Zbritur Sipërfaqja prej 3200 m2 E Përfutur nga Ligji 7501
51	Pogradec	Kadrie e Floresha Belli		Belli	2463	Vërtetim Kadastral Nuk ka Planvendosje Zbritur 537 m2 Truall Trajtuar më Parë

Table with 5 columns: Pogradec, Emri, Mbiemri, Adresa, and Vleratimi / Shtetëror / Planvendosje. Contains 100 rows of land auction data.

Table with 5 columns: Pogradec, Emri, Mbiemri, Adresa, and Vleratimi / Shtetëror / Planvendosje. Contains 100 rows of land auction data.

Dialogu Kosovë-Serbi, zëdhënësja e Mogherinit: Ende s'ka datë

Aleksandër Vuçiç: Serbinë e pret katastrofa rreth Kosovës

Mediat serbe: SHBA-të s'kanë paraqitur asnjë propozim

Zëdhënësja e përfaqësueses së lartë të BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Maja Kocijançiq ka deklaruar se ende nuk dihet data kur do të vazhdojë dialogu mes Beogradit dhe Prishtinës. Ajo ka shtuar se për aq sa di, takimi mes presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi dhe atij të Serbisë, Aleksandër Vuçiç nuk ishte i planifikuar për dje, shkruan "Danas". Kocijançiq ka shtuar se kontaktet me të dyja delegacionet po vazhdojnë, transmeton "Tg". Ajo ka përsëritur se përfaqësuesja e lartë e BE-së, Federica Mogherini nxit rregullisht shtetet anëtare të Bashkimit Evropian për dialogun mes Beogradit dhe Prishtinës. Ndërsa SHBA-të mbështetin dialogun Beograd-Prishtinë dhe me kërret e Serbisë, Kosovës, si dhe me zyrtarët e BE-së po konsiderojnë ide të ndryshme, por nuk kanë paraqitur asnjë propozim për një marrëveshje ligjërshite të detyrueshme për normalizimin e marrëdhënieve. Kështu, së paku shkruan agjencia serbe e lajmeve "Beta", është marrë një përgjigje nga ambasada amerikane në Beograd, rreth asaj nëse SHBA-të kanë ndonjë propozim të çfarëdo forme lidhur me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Amerika vazhdon të mbështetë dialogun e drejtuar nga BE, që synon normalizimin e plotë të marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës, po flasin për idetë e ndryshme me kërret serbe dhe kosovarë, si dhe me zyrtarët e BE, por nuk kemi paraqitur ndonjë propozim", citohet të ketë thënë ambasada amerikane në Beograd, në një përgjigje dërguar agjencisë serbe të lajmeve. "Serbinë e pret katastrofa rreth Kosovës". Kështu deklaroi presidenti Aleksandër



ALEKSANDËR VUÇIÇ:

"Serbinë e pret katastrofa rreth Kosovës. Fuqitë e mëdha nuk e njohin, nuk e kanë ndër mend ta respektojnë Rezolutën 1244 dhe kjo do të thotë se kemi shumë pak mundësi të bëjmë diçka", ka thënë presidenti serb, Vuçiç.

NIKOLA SELAKOVIÇ:

"Është e rëndësishme të vazhdojë dialogu, i cili siç duket nëse bllokohet, shkon në favor të Prishtinës. Unë shpresoj që sot ose nesër të caktohet një datë e re për dialogun në Bruksel", - tha sekretari i presidentit serb, Selakoviç.

Vuçiç. Gazeta "Danas" shkruan se mesazhi i Vuçiç se "fuqitë e mëdha nuk e njohin, përkatësisht nuk e kanë ndër mend ta respektojnë Rezolutën 1244 dhe kjo do të thotë se kemi shumë pak mundësi të bëjmë diçka", i është dedikuar opinionit të brendshëm dhe atij në Perëndim para fazës së re të negociatave me Kosovën. "Kohët e fundit Vuçiç po përgjatit opinionin në Serbi se është e mundshme katastrofa e plotë lidhur me Kosovën

dhe se në këtë rast është i mundshëm edhe një pozicionim i ri gjeopolitik i Serbisë, pra kthim më i madh drejt Rusisë", kanë thënë burime të kësaj gazete nga Beogradi, transmeton "Koha.net". Sipas tyre, Vuçiç edhe më tej shpreson në koncesione nga Perëndimi, sepse Perëndimi, përfshirë SHBA-të e BE-në do ta vlerësojnë që për shkak të paqes e stabilitetit të Ballkanit Perëndimor, Serbia të mos shtyhet në përfaqim edhe

më të madh drejt Rusisë. Ndërsa sekretari i përgjithshëm i Presidentit të Serbisë, Nikola Selakoviç ka thënë se është e rëndësishme të vazhdohet dialogu Beograd-Prishtinë. Selakoviç ka thënë për televizionin publik serb se refuzimi i Prishtinës për të mos e vazhduar dialogun nuk është asgjë e re. "I ri këtu është fakti se paraqitja e rreme apo cinike nga ana e Prishtinës kësaj here është shoqëruar me dhunë ndaj serbëve që jetojnë në Kosovë", transmeton "Iajmi.net". Sipas tij, është e rëndësishme që ambasada amerikane e ka karakterizuar sulmin ndaj serbëve si një akt të dhunshëm. Sekretari i presidentit serb mendon se përpjekja nga ana e

Prishtinës për të "tregtuar" me asociacionin ka qenë prej kohësh. "Është e rëndësishme të vazhdojë dialogu, i cili siç duket nëse bllokohet, shkon në favor të Prishtinës. Unë shpresoj që sot ose nesër të caktohet një datë e re për dialogun në Bruksel", - tha ai. Selakoviç ka theksuar se pala kosovare do të bëjë gjithçka për të ushtruar presion ndaj presidentit serb. "Unë kam besim tek ai dhe qytetarët e Serbisë duhet të kenë, pavarësisht presioneve. Ai di se si duhet marrë vendime në interes të shtetit dhe të kombit. Serbët në Kosovë nuk kanë aleat më të mirë se Vuçiç, që i kupton problemet dhe lufton për zgjidhjen e tyre", - tha sekretari i përgjithshëm i presidentit të Serbisë.

Grekët paralajmërojnë protesta të reja në Athinë

Çështja e emrit, ambasadori i SHBA-ve në Maqedoni: Duhet një zgjidhje e pranueshme

Vetëm pak ditë përpara Samitit të NATO-s në Bruksel, kur Maqedonia pritet të marrë ftesën për anëtarësim në Aleancë, më 8 korrik në Athinë janë paralajmëruar protesta kundër zgjidhjes që do të përmbante termin "Maqedoni". Ndërsa protesta e dy ditëve më parë në 24 qytete e ndryshme të Greqisë kaloi përgjithësisht e qetë dhe pa pjesëmarrje masive, sikurse protestat e shkurrit. Por sipas organizatorit të protestës, Oton Jakovidi, qëllimi i protestës së fundit nuk ishte pjesëmarrja ma-

XHES BEJLI:

"Vazhdojnë negociatat mes të dyja palëve me ndihmën e Kombeve të Bashkuara. Për shkak të çështjes specifike unë do u lë të dyja vendeve të gjejnë një zgjidhje të përbashkët të pranueshme, të cilën qytetarët e presin prej kohë të gjatë", deklaroi Xhes Bejli, ambasador i SHBA-ve në Shkup.

sive, por betonimi i qëndrimit grek kundër përdorimit të termit "Maqedoni" nga fqinji si dhe organizimi i referendumit për cilëndo emër për të cilën palët do të bien dakord. "Protestat e para në Selanik dhe Athinë dëshmuar num-

rin e madh të qytetarëve që nuk pranojnë që emri i Maqedonisë t'i jepet vendit fqinj, ndërsa në protestën e djeshme, qëllimi nuk ishte të tregohet pjesëmarrja, por që populli është plotësisht i koordinuar në bazë të ven-

ditimit të miratuar me rezolutat e protestave të mëparshme. Populli jo vetëm që kundërshtoi që fqinjit t'i jepet emri Maqedoni, por kërkoi organizimin e referendumit", - deklaroi Oton Jakovidi, organizator i protestës në Greqi. Ndërkaq, sipas zëdhënësës së Greqëve të Pavarur, partnerit të koalicionit qeveritar të kryeministrit Cipras, mobilizimi përmes protestave forcon pozitativ negociatave të grekëve. "Mendoj se kishite njerëz që i përkasin gjithë spektrit ideologjik... Protestat me të vërtetë e treguan patriotizmin e grekëve, frymën dhe dëshirën e grekëve që të mos përdoret termi Maqedoni", - u shpreh Madalena Papadopulo, zëdhënëse e Greqëve të Pavarur. Protesta e një dite më parë është vlerësuar si e suksesshme edhe për numrin e pjesëmarrësve, por edhe fak-

tit që kaloi pa incidente. Ata morën mbështetje e partive opozitare, autoriteteve lokale, por edhe nga priftërinjtë, njofton "Alsat M". Ndërkaq, SHBA-të prej një kohe të gjatë po u jepin mbështetje Greqisë dhe Maqedonisë lidhur me zgjidhjen e çështjes së emrit. Kështu ka deklaruar ambasadori amerikan në Maqedoni, Xhes Bejli, sipas të cilit zgjidhja e këtij kontesti do të sjellë të mira për të dyja vendet, por gjithashtu do të kontribuojë edhe për paqe dhe prosperitet në tërë rajonin. "Vazhdojnë negociatat mes të dyja palëve me ndihmën e Kombeve të Bashkuara. Për shkak të çështjes specifike, unë do u lë të dyja vendeve të gjejnë një zgjidhje të përbashkët të pranueshme, të cilën qytetarët e presin prej një kohe të gjatë", deklaroi Xhes Bejli, ambasador i SHBA-ve në Shkup.

SHKURT

Shpërthen vullkani, fshatrat kthehen në varre masive

Hiri i ka zhdukur fshatra të tërë në zonën përreth majës së Vullkanit të Zjarrit në Guatemalë. Bilanci tragjik i viktimave është thelluar në 100. Në listat e personave të zhdukur pas shpërthimit të dytë të së martës ndodhen emrat e rreth 200 personave. Ekipet e emergjencës po kërkojnë në çdo ndërtesë të mbuluar nga llumi e balta ende e nxehtë e përhapur nga vullkani në rajonin e El Rodeos në jugperëndim të vendit, por e kanë të pamundur të identifikojnë viktimat. Siç përkrahëjnë ata, pjesa më e madhe e trupave janë djegur në temperatura deri 400 gradë. Funksionimi i efektiv i sistemit të alarmit nga vullkani shihet si një prej shkaktarëve të një numri kaq të lartë të vdekurish. Prej vitit 2002, vullkani në majën e lartë 3700 metra ka keq shumë pak aktiv. Prej së dielës, kur ndodhi shpërthimi i parë autoritetet kanë evakuuar 12 mijë njerëz.

Putin: Lufta e Tretë Botërore mund të jetë fundi i civilizimit

Presidenti i Rusisë, Vladimir Putin ka deklaruar se rreziku i një Luftë të Tretë Botërore mund të jetë fundi i civilizimit. Për këtë arsye, shtet duhet të reduktojnë konfliktet mes tyre. Gjatë një deklaratë televizive, presidenti rus u bëri thirrje fuqive ndërkombëtare që të mos përfshihen në konflikte globale, pasi kjo do të përbente një rrezik për civilizimin. "Nuk e di se me çfarë armësh do të luftohet në Luftën e Tretë Botërore, por Lufta e Katërt Botërore do të luftohet me shkopinj dhe me gurë", tha Putin, duke cituar Albert Einstein.

E kafshoi gjarpri i ngordhur, burri injekton 26 doza antihelm

Një burrë në Shtetet e Bashkuara rrezikoi seriozisht jetën kur u kafshua nga një gjarpër i ngordhur. Ngjarja ka ndodhur në Teksas, ku burri ishte duke punuar në kopshtin e shtëpisë së tij. Njëpër shkretët, ai pa gjarpërin dhe e vrau duke e ndarë në disa pjesë. Në momentin që mori trupin e copëtuar të gjarpërit për ta hedhur në mbeturina, koka e këputur e zvarranikut e kafshoi duke e helmuar. Shëndeti i tij u rëndua dhe u dërgua në spital. Mjekët i injektuan atij 26 doza antihelm. Më shumë se një javë pas incidentit, burri është shfaqur në gjendje të qëndrueshme me disa shqetësime të vogla në veshka.

MEZOSOPRANOJA

“Zbulim vokal fantastik”, Vikena Kamenica shkëlqen në Francë

Fatmira Nikolli

“Me Dalilen e Vikena Kamenices Opera-Theatre në Metz (Francë) ka bërë përsëri një zbulim vokal fantastik. Mezzo-soprano që ka bërë para dy vjetësh në të njëjtën skenë Mama Luciano (Cavalleria Rusticana të Maskanjit), tregoi që në shfaqjen e parë që ajo zotëron të gjithë tesiturën e rolit të Dalilës, duke kaluar me virtuozeitet nga notat e poshtme me mbështetje dhe thellësi, drejt notave të larta me butësi dhe ëmbëlsi. Me frazën ‘Qu’importe à Dalila ton or, et que pourrais tout un trésor. Si je ne rêvais la vengeance’, ajo jo vetëm arrin të shprehë të gjithë urrejtjen dhe etjen për hakmarrje, por edhe të tregojë mjeshhtërinë vokale me të cilën ajo kalon në tre regjistra të ndryshëm dhe më të njëjtën frymëmarrje”. Ka qenë kjo një prej kritikave për Vikena Kamenicën, e cila interpretoi në Metz të Francës rolin e Dalilës. Mezosopranoja shqiptare ka korrur sukses me rolin e interpretuar atje duke tërhequr vëmendjen e kritikës dhe duke marrë vlerësimin e publikut, për interpretimin, zërin dhe kalimet emocionale të herëpashershme në tri aktet e Dalilës. Ajo është ende në Francë pas tri shfaqjeve dhe prej andej, ndan emocionet e para me “Gazeta Shqiptare”. “E kanë si vepër monumentale të tyre dhe ka pak personazhe. Isha e vetmja e huaj në këtë vepër dhe nuk flisja as frëngjisht, ndaj për mua kishte një ngarkesë të madhe emocionale”, tha dje ajo në linjë telefonike. “Samson et Dalila” (1877), është kompozuar nga Camille Saint-Saëns me libret të Ferdinand Lemaire.



Vikena Kamenica

Mezosopranoja: Emocionet dhe frika në rolin e Dalilës në Metz

akti mbyllet. Hyn me një arie shumë të fortë që tregon atë turbullirat e saj dhe e sigurinë për t’i shkuar hakmarrjes deri në fund. Më pas vjen një duet me një bariton që në rastin konkret ishte Ale-

ksander Duamel. Ka një kapërcim të fortë dhe dinamik kur Dalila kalon në joshje maksimale e Samsoni e kërkon në dhomën e kësaj. Nis këtu dueti i dashurisë, hyn aria më e rëndë-

sishme ku ajo përpigjet të zbulojë sekretin deri kur Dalila shpërthen pasi ka shfrytëzuar çdo armë”, tha Kamenica, duke përkrahur gjendjet emocionale të Dalilës, që përcaktojnë njëherësh edhe shkallën e vështirësisë së interpretimit të mezosopranos. Për Kamenicën, akti i

fundit i flijimit ka një peshë të bukur e të madhe sepse është kori, janë solistët, është baleti. “Hyn te veprat e bukura me muzikë të jashtëzakonshme. Kisha shumë përgjegjësi dhe frikë meqë nuk e kisha provuar asnjëherë”. Më herët në një status në “Facebook”, ajo ka falënderuar Ermonela Jahon për mbështetjen shpirtërore që i ka dhënë. “Vazhdoj e besoj akoma më tepër sloganin tënd ‘që kur jemi bashkë, bëhemi akoma më të fortë’. Të dua shumë e të jam mirënjohëse pafundësisht!”, shkroi Vikena.

Më tej, ajo vuri në dukje se një nga njerëzit që besoi kaq shumë që ditën e parë që e ka takuar ka qenë regjisori i veprës, Paul-Emile FOURNY një super artist, që me punën e tij e ngarkoi këtë debut të fortë emocional e së bashku me stafin e Opera Metz e bëri të përjetojë një ëndërr të bukur! Për dirigjentin Jacques Mercier, Vikena përmend ndihmën për shkrihimin muzikor dhe vë në dukje punën e palodhur të ‘chef du chant’ Natalie Dang për analizën e çdo note dhe fjalë deri në shfaqjen e fundit!

menica tha se “Samson e Dalila” është një nga veprat më të rëndësishme për repertorin francez. Vikena rrefeu për “GSH” se si prova gjenerale edhe të tria shfaqjet shkuan mirë. “Prita kritikën që të fliste si gjithë artistët e tjerë. Jam shumë e kënaqur për kritikën e mirë. Është një nga sfidat më të forta dhe debut, sepse nuk e kisha kënduar asnjëherë në jetën time. Nuk që e lehtë të bëja premierën jo në vendin tim çka do më lironte nga emocionet, por në vendin ku autori e ka shkruar veprën dhe audienca e është vetëm franceze”, tha ajo. Kamenica u shpreh se ka ndjerë shumë përgjegjësi, por prita ishte shumë e mirë. “Dalila është një personazh që unë e adhuroj. Jam e dashuruar me rolin e Dalilës, për dinamikat e forta që ka, për emocionet e forta që kalon, dashuron e urren në të njëjtën kohë. Ka aktin e dytë që është një nga momentet më të forta që Dalila mezosoprano kalon, sepse futet në skenë dhe nuk del derisa

Në këtë mes, vetëm një të dyja kemi lidhje: ajo që kërkon që unë të jap atë çka natyra e saj dhe rrethanat ia ndaluan ta jepte, unë që nuk arrij të jap atë çka ajo pretendon; ajo që nxehtë me pazotësinë time dhe për inat do të më shndërrojë në hiç siç bëri me veten, mua që shkrova muaj e muaj me radhë për t’i dhënë një trajtë që të mos tregtet, dhe ta mundja, dhe ta qetësoja dhe kësajoj të qetësohesha edhe vetë”. - Botime Pegi, qershor 2018.

Vjen në shqip më në fund, një prej librave të shumëpritur. Përkthyer nga Agim Doksani, nën logon e “Botimeve Pegi”, “Historia e va-

“Historia e vajzës së humbur” të Elena Ferrantes



zjës së humbur” është vëllimi i katërt dhe i fundit i “Mikeshës gjenerale” të Elena Ferrante, sagës që e ngrii autore në shkallën e një prej shkrihtarëve më të mira në botë.

Në fillim, pamë dy vajzat e vogla të hidhnin qëllimisht kukullat e tyre prej lecke në bodrumin e don Akil Karraçit, që mban nën kontroll gjithë të varfrit me anë të mekanizmave korruptues; të atij përbindëshi të pamëshirshëm, në portën e të cilit vendosën të trokisinin me atë shkas, duke ngjitur shkallët e duke ecur dorë për dorë me njëra-tjetrën për të marrë zemër, njëra përpara, Lina, e paepur, trimë, tjetra pas, frikacake e gjithnjë një

qendër të të cilit mbetet ujdia e rreptë e bashkëpunimit mes protagonistëve - zë fill një lojë pasqyrash dhe shkëmbimesh, ku mezi arrijmë të deshirojmë se cila prej të dyjave është “mikesha gjenerale”. Dy vajzat tashmë janë të rritura, më pas të moshuara. Që prej viteve ‘50-të deri më sot kanë përjetuar ndryshime epokale, kanë arritur e kanë dëshmuar me sytë e tyre një mirëgenie të papritur, pastaj mohimin, dehjen e lirisë së hershme seksuale, dehjen politike, vitet e plumbta, terrorizmin; kupola e kamorristëve, që kontrollon gjithçka dhe përcakton rregullat e lojës, bëhet gjithnjë e më kanosëse. Dy

hap mbrapa. Qysh prej atij çasti, që prej asaj “skene të parë” - që theu digën dhe shpërtheu vrullshëm rrjedhën e rrëfimit, në

STUDIMI


Ngjashmëri mes kanunit verior e kodeve të nordikëve në kohën e vikingëve

Nga Sadik Bejko

Prof. Xhevat Lloshi ka energjinë që pa u ndalur të na dhurojë libra me vlerë. Botimi më i fundit me firmën e tij, bashkautor me John Quanrud, është "Skënderbeu në vendet nordike", (192 faqe), botim i Institutit për Studime Shqiptare dhe Protestante. Tema e librit është e gjitha në titullin që përmendëm, vlera e tij është e shumëfishtë. Ky libër sjell punime kërkimore dhe studimore të hartuara sipas kritereve të ngulëta akademike, punë që përfshijnë një periudhë kohore mbi tridhjetëvjeçare, që nga vitet '80, të shekullit që shkoi e deri sot. Realizimi dhe botimi i këtij libri me këndvështrim të reja për heroinin tonë kombëtar vjen në këtë Vit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriotit Skënderbeut. Për t'u ndalur me konkretisht, bashkautorë të këtij libri, veç prof. Xhevat Lloshit dhe dr. John Quanrud, janë edhe Rolf Ködderitzsch (Universiteti i Bonit) dhe Tortsten Meissner (Universiteti i Kembrixhit) me studimin "Shqipëria në prozën letrare të vjetër nordike" (1990), Ludvig Holberg me trajtesën historike "Skënderbeu, prijësi dhe heroi më i madh në histori", botuar në gjuhën daneze më 1739. Në këtë libër trajtesa e Holbergut

vjen e përkthyer prej danishtes së vjetër nga John Quanrud; Sir William Craigie (pedagog në kolegjin Orielt të Oksfordit) me "Poezia romantike e Islandës", (1949); Finborgi Gudmundsson (ligjërues universitar dhe drejtor i Bibliotekës Kombëtare të Islandës) me "Skënderbeu në burimet islandeze", (1985); Matthew J. Driscoll (profesor i filologjisë së nordishtes së vjetër) me "Skënderbeu një hero shqiptar me petk islandez". Prof. Xhevat Lloshi, veç punës kërkimore, është përzgjedhësi dhe konceptues i librit, përkthyesi i lëndës nga anglishtja, hartuesi i parathënies, 30 faqe, hartuesi i punimeve "Skënderbeu në penën e historianit të madh Holberg" dhe "Skënderbeu dhe rimuret islandeze". Libri është i pajisur me shënime për secilin nga studimet dhe në fund me një bibliografi për veprat dhe autorët kryesorë që u referohet lënda e studimeve. Jepen dhe adresat mbi publikimet e mëparshme të disa prej këtyre punimeve. Libri sjell të dhëna mbi historinë, gjeografinë, gjuhën dhe letërsinë e vendeve nordike, shqyrtton me prova dokumentare dukurinë e kontakteve të hershme midis shqiptarëve dhe skandinaveve, kontakte të gjysmës së parë të shek. XI, shumë kohë më përpara epokës së Gjergj Kastri-

Botohet libri "Skënderbeu në vendet nordike" nga Xhevat Lloshi e John Quanrud



otit. John Quanrud ka një punim pikërisht mbi këto kontakte të hershme shënuar në librin "Histori e Perandorisë Bizantine", 1070, të historianit dhe të juristit bizantin Mihail Ataliates. Sipas J. Quanrud, ndërveprimi i hershëm i skandinaveve (Latinoi) me shqiptarët (Alban-

oi), të quajtur kështu nga M. Ataliates, mund të ketë sjellë ngjashmëri midis Kanunit verior shqiptar me kodet ligjore gojore të nordikëve të periudhës së vikingëve, tezë të cilën ai e ka në duar, po e harton. Dr. John Quanrud në punimin e tij ndërhyr në një debat shkencor me pro dhe kundër për të mbrojtur tezën se Albanajt të Historia e M. Ataliates janë shqiptarë. Për këto kontakte të hershme flet edhe punimi i Rolf Ködderitzsch dhe Torsten Meissner; sipas tyre, Shqipëria, qyteti i Durrësit, përmenden në tri saga të vjetra nordike të shekujve XII dhe XIV.

Në rrëfimin e tij historik mbi heroinin tonë kombëtar, frymëzuar nga Barleti, botuar më 1739, historiani dhe shkrimtari i shquar danez i shekullit XVIII, Ludvig Holberg, e quan Skënderbeun "prijësi dhe heroi më i madh në histori". Më tej jepen edhe autorë të tjerë që kanë frymëzuar hartuesin nordik të historisë së Skënderbeut. Përhapja e historisë dhe e figurës së Skënderbeut nga rrëfimet e historianëve u shtri më pas në letërsinë e shkruar në formën e sagave dhe të këngëve epike, të quajtura rimure. Përgjithësisht libri i Holbergut ka qenë në bazën e shumë sagave mbi Skënderbeun (gjithsej 15) dhe të disa poemave epike, rimure, të autorëve islandezë. Natyra e sagave si rrëfija heroike kërkonte përshtatjen e historisë së Holbergut, në gjuhën dhe në mjetet shprehëse të sagave islandeze, ndërime në veten e foljeve, në përshkrimet e betejave, në portretizimin e heroit. Në punimet studimore jepen me hollësi procedimet tilla që e lartësojnë heroinin tonë, saqë, sipas studiuesve, ai merr petkun islandez, pa ndërruar asgjë në ngjarjet e bëmat, mbështetur këto në historinë e Holbergut. Rimuret si poezi e tipit të rapsodive tona janë ritregime në poezi të sagave. Rimuret janë më të gjata se sagat; kanë shitesa të strukturës poetike si hyrjet, kanë shitesa në fjalë në përpunje me metrin dhe rimat që kërkon hartimi poetik. Këto saga dhe rimure kanë qarkulluar në formën e dorëshkrimeve nga një shekull në tjetrin. Këto forma letrare kanë qenë gjerësisht të përhapura dhe shumë të pëlqyeshme; kanë luajtur rolin kryesor në

heroinat, Lina dhe Elena, tashmë kanë mbi shpinë një jetë plot ngjarje, zbulime, rrëzime dhe "rilindje". Elena, shkrimtare e njohur, nënë e dy vajzave, kthehet në Napoli për t'i rënë pas një dashurie rinore, që u bë sërisht e pranishme në jetën e saj të re. Lina nuk është larguar kurrë nga Napoli, ku arriti të ngrinte një karrierë të mahnitshme si sipërmarrëse informatike, duke ushtruar më shumë se kurrë rolin e saj karizmatik dhe magnetik si lidhëse e fshehtë, por e vërtetë e lagjes. Dy grate, pole vërtet të kundërta të së njëjtës forcë, takohen dhe përplasen, ndikojnë mbi njëra-tjetrën, largohen e sërisht gjenden, zi-plepsen dhe admirojnë shoshoben. Ky vëllim i katërt dhe i fundit përbëll një vepër letrare jashtëzakonisht pjellore dhe

frymëzuese, një vepër e pranuar ndërkombëtarisht si një prej më të mirave të kohës sonë. "Historia e vajzës së humbur" nuk i jep sagës një fund qetësues, por pohon edhe njëherë se Ferrante është një prej zërave më të fortë të narrativës bashkëkohore. Media ndërkombëtare ka shkruar se saga napolitane është një histori klasash, përveçse gjinësh; Ferrante ofron një portret të gjallë e të saktë të asaj që mbetet nga ndjenjat (irracionale) të pamjaftueshmërisë, të cilat përndjekin njerëzit që ia nisnin nga hiçi. Si trillim, këta libra janë njëkohësisht dhe thellësisht realistë dhe qundërtrish intimitë. "Ishin vite të ndërlikuara. Rendi i botës ku qemë rritur po shpërblëhej. Afërsisht e vjetra të fituara falë studimit të gjatë dhe shkencës

së vijës së drejtë politike befash dukeshin një mënyrë e pakuptimtë për të zënë kohën. Anarkist, marxist, gramshist, komunist, leninist, trockist, maosit, punëtorist, po bëheshin me shpejtësi etiketime të vonuara apo, më keq akoma, një damkë shtazërie. Shfrytëzimi i njeriut nga njeriu dhe logjika e fitimit maksimal, që dikur mbaheshin si dënkë e neveritshme, tani ishin kthyer kudo në shtylla mbajtëse të lirisë dhe të demokracisë. Ndërkaq, përmes rrugësh të ligjshme dhe të paligjshme, tërë hesapet e hapura brenda shtetit dhe brenda organizatave revolucionare po mbylleshin me dorë të fortë. Fare lehtë mund të përfundojë i vrarë ose në burg dhe mes njerëzve të zakonshëm, kishte plasur paniku", shkëpusim nga libri. Historia

ria e miqësisë së dy grave, fundi i së cilës ende nuk dihet. Elena Ferrante është pseudonimi i autorese së dhjetë veprave letrare, ndër të cilat edhe saga napolitane, e konsideruar si kryevepra e saj, nga pikëpamja e kritikës letrare, por edhe falë suksesit të jashtëzakonshme me lexuesit. Emri i vërtetë i autorese mbetet ende zyrtarisht i pakonfirmuar. Në 2011 u botua kapitulli i parë i sagës napolitane, "Mikesha gjeniale" (i botuar në shqip në nëntor 2016), i ndjekur nga libri i dytë, "Mbiemri i ri" (i botuar në shqip në korrik 2017), vëllimi i tretë, "Histori arratie e qëndrese", dhe nga libri i katërt dhe i fundit, "Historia e vajzës së humbur".

Dje në "Deutsche Welle"

"G7" - një model që i ka kaluar afati?

Nga Sabine Kinkartz

(vijon nga faqja 1)

... Ata kanë punuar shumë javët e fundit, por të ashtuquajturit "sherpas", shefat e negociatave në "G7", ende janë shumë larg qëndrimeve të përbashkëta që duhet të miratohen në samitin e Kanadasë, që do të mbahet në Charlevoix. Negociatat do të vazhdojnë deri në fillimin e samitit të premtën, thuhet në qeverinë gjermane. Qëllimi është arritja e një "landing zone" të përbashkët.

Të premtën dhe të shtunën do të takohen presidentët dhe kryeministrat e Gjermanisë, Francës, SHBA, Kanadasë, Japonisë, Italisë dhe Britanisë së Madhe. Temat e "G7" janë krizat dhe konfliktet në Korenë e Veriut, Siria dhe e ardhmja e raporteve me SHBA, pas vendimit për daljen e saj nga programi bërthamor me Iranin. Tema të tjera janë edhe mbrojtja e klimës dhe në veçanti tregtia, si fushë e re mosmarrëveshjes me SHBA-në.

DEKLARATA PËRFUNDIMTARE LARG MARRËVESHJES

Nëse në këtë samit do të ketë ndonjë deklaratë të përbashkët, ende nuk dihet. Organizatorët po përpunojnë që të gjejnë një gjuhë të përbashkët. Deklarata e përbashkët nënkupton edhe një marrëveshje paraprake. Deklarata nga samiti i fundit në Taormina të Italisë ka dështuar për shkak të qëndrimeve të kundërta për mbrojtjen e klimës. Ndërsa tani ka një varg pikash ku palët kanë qëndrimet kundërtë. Presidenti Donald Trump mendon ndryshe për shumë çështje.

Në Taormina është vendosur që në deklaratë të thuhet se palët kanë qëndrime të ndryshme për klimën. Nëse edhe në Kanada vendoset që të shënohen pikat e mosmarrëveshjes, atëherë dokumenti përfundimtar do të ketë më shumë mosmarrëveshje se sa marrëveshje dhe nuk do të ketë peshën e zakonshme.

TË GJITHË KUNDËR NJËRIT

Ndërkohë po mendohet seriozisht nëse vetëm organizatori i samitit duhet të përgatisë një



kumtesë të përbashkët, ku do të flitej për vlerat e përbashkëta për multilateralizmin, tregtinë e lirë dhe përgjegjësinë për klimën. A do të thotë kjo pra se një formati të tillë të takimeve po i vjen fundit? Presidentët dhe kryeministrat e "G7" janë përpjekur deri tani që të nënvizojnë vlerat e përbashkëta multilaterale. Këtë thekson edhe qeveria gjermane. Këtë e thotë edhe Kancelarja Angela Merkel.

Por jo të gjithë janë për vlerat

multilaterale. Harmonia është prishur pas ardhjes së presidenti Trump në pushtet dhe me siguri që nuk do të kthehet shpejt. Tani bëhet fjalë për një grup të përcarë, shkruajnë mediat kanadeze. Ministri francez i Financave Bruno Le Maire e tha qartë para disa ditësh, kur foli për një takim të "tendosur dhe të rëndë", me kolegët nga "G7". Mosmarrëveshjet rreth doganave amerikane për çelikut dhe aluminin janë të mëdha.

"G6 + 1"

Takimi i ministrave të Financave dëshmoi se G7 të premtën dhe të shtunën mund të shndërrohet në një takim ku gjashtë vende do të kenë qëndrime të ngjashme, ndërsa SHBA mund të jetë kundër. Por aktualisht askush nuk do të heqë dorë nga "G7", në këto kohëra krizash dhe qëndrimesh ekstreme. Kjo është një mundësi e mirë për takimin e presidentëve dhe kryeministrave të vendeve industriale më të zhvilluara.

HOROSKOPI

DASHI

Dashuria do t'ju godasë në mënyrë të pazëritshme, thellësisht, ndoshta edhe pak në mënyrë të misterhme, por e sigurt që do të jetë një përvojë e këndshme. Në punë bëni bilancin dhe verifikoni nëse jeni duke bërë atë që doni. Kërkoni gjithmonë të ndiheni mirë.

DEMI

Merrni vendimet duke ruajtur ekuilibrin dhe duke shmangur reagimet gjaknxehta. Duhet patjetër të tregoheni të kujdesshëm. Nëse do t'ia lejoni, një familjar do të jetë i lumtur t'ju ndihmojë. Mos lini që kjo mundësi t'ju ikë. Përfitoni.

BINJAKET

Bashkëpunimi i Plutonit, Uranit dhe Venusit ju favorizon që të rinovoni disa gjëra në fushën e dashurisë, për të vendosur më shumë mirëkuptim me partnerin. Hëna miken ju shtyn të ëndërroni, por mbajini sytë hapur kur vjen puna për bazën materiale.

GAFORJA

Gjithçka do të shkojë për më mirë, mbi të gjitha nëse kërkoni të veproni në aktivitetin tuaj, gjithmonë duke u bazuar në kriteret e paanshmërisë dhe respektit për të tjerët. Venusi do të jetë pak dinak ndaj jush dhe sot do të keni si situata pozitive, ashtu edhe kokeqarje të vogla.

LUANI

Po jetoni një histori të bukur dashurie, ndaj bëni kujdes për të mos e ndërlikuar çka është e thjeshtë. Kush është beqar, ka mundësi të shkëlqyera për një takim të këndshëm. Organizoni një shëtitje në natyrë për të medituar mbi zgjedhjet tuaja më të fundme.

VIRGJERESHA

Me pozitivitetin e tyre, Dielli dhe Hëna ju mbështesin për të pasur një ditë të mbarë. Do të dini të përballeni me qetësi me çdo rrethanë. Dita e sotme do të karakterizohet nga entuziazmi, si edhe me perspektiva të mira që parashikohen.

PESHORJA

Mësoni të vëzhgoni dhe do të zbuloni se jeta çdo ditë mund t'ju dhurojë ato gjëra të vogla të bukura që mund të bëjnë të lumtur cilindo prej nesh. Bëni kujdes nga lodhja nervore, pasi jeni shumë të ndjeshëm ndaj gjendjes emocionale të atyre që ju rrethojnë.

AKREPI

Diën e sotme, me ogurin e mirë nga bashkëpunimi i Uranit, Saturnit, Jupiterit dhe Plutonit, do të përjetoni gjëra të reja pozitive në fushën e dashurisë. Keni nevojë të ndryshoni, të bëni gjëra të reja, të sillni ndryshime të frytshme në ekzistencën tuaj.

SHIGJETARI

Për shkak të planetëve që janë shumë tekanjorë ndaj jush, nganjëherë kush ju qëndron prandë, mund t'ju duket se ju kundërshton. Kërkoni një bisedë sinqerose. Ndërkaq, duke qenë nën ndikimin e theksuar Uranit, mos e merrni çdo gjë për të mirëqenë.

BRICJAPI

Me mbështetjen që keni nga Urani nuk duhet të ngadalësoni ritmin për të realizuar një projekt me sukses. Ndoshta do t'ju duhet një kohë e gjatë, por kjo nuk përbën problem. Në jetën në çift, Jupiteri do t'ju ndihmojë të stabilizoheni dhe të ndërmerri rrugën e qëndrueshmërisë.

UJORI

Me Plutonin që ju mbështet, thellohuni te gjërat që ju përshtaten dhe ju interesojnë më shumë dhe do të rrisni kompetencat tuaja profesionale. Plutoni bashkëpunëtor do t'ju ndihmojë të zgjeroni horizontin dhe të pasuroni lidhjet me të tjerët.

PESHQIT

Bashkëpunimi i Marsit me Venusin ju dhuron energji për t'ju përkushtuar angazhimeve të përditshme. Ndërsa Saturni ju mbështet me ide gjelbra për të lëvizur gjithçka. Do t'ia dini të nisni një projekt që po e mendoni prej shumë kohësh dhe rezultatet nuk do të vonojnë.



Hasan Likës nuk i ka mjaftuar arritja historike me ekipin e Luftëtarit, teksa ndarja e tij nga bluzinjtë ishte e pashmangshme në fundin e sezonit. Drejtimin e skuadrës tashmë e ka marrë tekniku sloven, Kostić, që i është vendosur si objektiv nga klubi për të dalë gjithmonë në vendin e 3, për sa kohë ai të qëndrojë në drejtimin e Luftëtarit. Në një intervistë për "RTSH Sport", Kostić është shprehur se qëllimi i tij është për të zhvil-

Trajneri sloven i gjirokastritëve

Kostić: Dua ta kthejmë Luftëtarin në një klub stabël

luar një lojë të bukur dhe që skuadra e tij të realizojë sa më shumë gola. "Kur je në punën e trajnerit, ke gjithmonë njohuri për ligat e Europës, duke përfshirë edhe kampionatin shqiptar. Megjithatë sapa u kontaktova nga Luftëtarit, unë

u interesova më tepër për Superiore dhe kam parë të gjitha ndeshjet e dy viteve të fundit të Luftëtarit, për të ditur se çfarë më pret. Nga Luftëtarit janë larguar dy sulmuesit e krahëve, gjithashtu, është i dëmtuar edhe një prej

qendërmbrojtësve. Përforci- met duhet të nisin nga aty, por kjo nuk do të thotë se nuk do të shohim për lojtarë që luajnë në role të tjera. Nga problem nëse këta lojtarë që do të afrohen janë shqiptarë, slovenë apo të ndonjë shteti

tjetër, mjaftojnë që ata të jenë të aftë në rolet e tyre. E dimë rregullin që lejohen vetëm 4 lojtarë të huaj dhe prandaj po përpiqemi që të gjejmë disa elemente në Shqipëri. Dihet pika e marrëveshjes, synojmë që Luftëtarit të kthehet në një klub stabël dhe duhet të luftojë të paktën për vendin e tretë. Objektivi im personal është që të luaj një futboll të bukur, të shënojë gola, që duhet të na japin edhe rezultatin e duhur", -ka thënë Kostić.

Në pritje të trajnerit të ri, që sipas të gjitha gjasave mund të jetë Guti, Perez ka telashe të tjera

E bujshme, Ronaldo ka vendosur largimin nga Reali

Lajmin e publikon gazeta portugeze "Record"




që të largohet. "Record" shkruan se fati i pesë herë triumfuesit të "Topit të Artë" është midis Francës, Italisë dhe Anglisë. 33-vjeçari mund të rikthehet në Manchester tek "Djajtë e kuq", aty ku nisi ëndrra e tij dhe ngriti për herë të parë çmimin "Topi i Artë". Por, nuk mbeten pas as pistat për një aventurë të re në kampionatin francez me PSG-në, të

cilët gjithnjë kanë pasur interes për të nënshkruar me yllin portugez. **TRAJNERI I RI**
Real Madridi e kërkon me ngulim një trajner të ri pas dorëheqjes së Zinedin Zidane-it. Janë disa emra në listën e drejtuesve të "galaktikëve" për stolin, por në orët e fundit është futur një emër mjaft interesant. Ish-trajneri i Napolit, Mauricio Sar-

ri ka tërhequr vëmendjen e presidentit Florentino Perez që tani po mendon t'i bëjë atij një ofertë. Tekniku italian vlerësohet së tepërmi për filozofinë e tij dhe për lojën që skuadrat që drejton bëjnë në fushë. Vlerësimet kanë qenë të mëdha nga kolegët e tjerë në Itali dhe Evropë, megjithatë, drejtuesit janë disi në mëdysheje, sepse ai ka herë-herë një

sjellje jo shumë të pranueshme. Sidomos me deklaratat e tij që shkaktojnë polemika. Dhe të "galaktikët" ka një rëndësi të madhe që strategu i skuadrës të jetë i matur. Lajmi u bë publik nga televizioni "El Chringuito TV". Ndërkohë presidenti i Mursia, Viktor Galvez tha se trajneri i ardhshëm i Real Madridit do të jetë legjenda e klubit, Guti. Ish-mesfushori i "Los Blancos" është në poleposition për të marrë postin e trajnerit. Bosi i Çelsit, Antonio Konte dhe ai i Juventusit, Maks Alegri, u përforcën si dy kandidatë për postin e teknikut të madrilenët. Klubi i Mursias donte të emëronte ish-mesfushorin Guti si trajnerin e tij të ardhshëm dhe Galvez pretendon se, nëse Zidane do ta kishte dhënë dorëheqjen disa ditë më vonë, klubi i tij do të kishte firmosur kontratën me 41-vjeçarin. Në vend të kësaj, tani Hoze Maria Gutierrez Hernandez i njohur ndryshe si Guti do të emërohet si trajneri i ri i Real Madrid.

SULMUESI



Qabala, 120 mijë dollarë për Xhejms Adenij

Xhejms Adenij kërkohet nga skuadra e Qabala në Azerbajxhan. Sulmuesi i Skënderbeut, sipas "Supersport" ka tërhequr vëmendjen e klubit të njohur azer, që ka ofruar 120 mijë dollarë për blerjen e kartonit të tij. Kjo është oferta konkrete që ka ardhur në adresë të klubit korçar nga Qabala. Tashmë përgjigja i takon Skënderbeut, që është në pritje të përgjigjes së KAS-it për anulimin e dënimt me 10 vite përjashtim nga Kupa e Europës. Nëse Skënderbeu fiton të drejtën për të luajtur në Champions, ndoshta nuk do të ishte dorë nga James, që ishte protagonist gjatë sezonit të shkuar në kampionat me korçarët.

MBROJTËSI

Mbrojtësi shqiptar, Renato Arapi ka zyrtarizuar largimin e tij nga ekipi turk, Bulaspor, duke dalë kështu si një futbolist i lirë. Ka qenë vetë lojtari ai i cili ka njoftuar shkëputjen e kontratës me klubin turk, ku nëpërmjet një postimi në rrjetin social "Instagram" ka njoftuar për ndërprerjen e bashkëpunimit, duke falënderuar njëkohësisht të gjithë ata të cilët i kanë qëndruar pranë në momente të vështira. "Së pari dua të falënderoj të gjithë

Arap i ndahet me Boluspor, ka oferta nga Superliga

ata që kanë punuar me mua, stafin e lojtarët, presidentin dhe bordin e tij dhe të gjithë ata që më kanë përkrahur brenda dhe jashtë fushës duke përfshirë këtu të gjithë tifozët dhe qytetarët e Bolus. Për mua ishte një eksperiencë e mrekullueshme që do të mbetet gjithmonë në zemrën time. I uroj më të mirat Boluspor-it", shkruante Arapi në "Instagram". Mbrojtësi

shqiptar nuk ka bërë të ditur se ku do ta vazhdojë karrierën, por nuk përjashtohet një rikthim i tij në Kategorinë Superiore, ku shumë skuadra mund të tentojnë të sigurojnë shërbimet e tij. Më parë ai ka qenë pjesë e Besës, Partizanit dhe Skënderbeut, prandaj adaptimi i tij në futbollin shqiptar nuk do të ishte shumë i vështirë.

BOTËTORI NË PRAG

Peter Pakult nuk e sheh Gjermaninë si favoritin kryesor për të fituar Kupën e Botës 2018. Edhe pse skuadra e drejtuar nga Joakim Lëv është mbajtëse e trofeut, trajneri i Kukësit beson se ndryshimet në këto vite kanë bërë që ajo të mos jetë më një prej ekipeve kryesore për të fituar këtë turne, e kaluar nga emra si Brazili, Spanja e Franca. "Duhet të jemi të sinqertë, këtë vit ato nuk janë favoriti kryesor", tha Pakult i ftuar në një stu-


Pakult: Gjermania nuk është favorite, Erdogan mund të bëhet problem

dio televizive në Austri. "Shumë lojtarë të rëndësishëm nuk janë më në të njëjtën formë në vitet e fundit. Kjo ndoshta ka të bëjë me ndryshimet e shumta. Dhe pastaj, nëse skandalin me foton e Erdogan bëhet problem për lojtarët, sigurisht që do të kthehet në një të tillë edhe për skuadrën", theksoi trajneri. Austria e tij mungon në këtë turne, por Pakult ka



bindjen se në European, ajo do të kthehet përsëri mes pjesëmarrësve të turneve madhorë. "Me një trajner të ri si Franko Foda, ekipi do të ketë një motivim të ri", theksoi tekniku i Kukësit.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Pupi regjisor.
- Kujtohet për një fitore të grekëve ndaj persëve
- Turner aktore.
- Fillojnë festat.
- Skuadër greke.
- Falen pa fe.
- U shkrua nga Gorkij.
- Një sferë për... model.
- Janë bisha.
- Parashtesë për dy.
- Demoni që persekutonte Sarën.
- Stacion i famshëm orbital.
- Mendes regjisor.
- Një rreth i ngushtë miqësor
- Film me Robert de Niro dhe Jean Reno
- Këndohen në opera.
- Është lajm i vjetër.
- Sharif aktor.

- Martin i Norma Rae.
- Mund të jenë filmi.
- Një jepet për hartim.
- Ami i Maupassant.
- Fundi i Turandot.
- Hallit këngëtare.
- Neill i Jurassic park.
- Pineda e Garcia Lorca-s.
- Giorgio stilist

VERTIKAL

- Morissette këngëtare.
- Kilmer aktor.
- Heche aktore.
- Fillojnë tatëpjetën
- Është diapozitiv shumë i ndjeshëm.
- Mbyllin spitale.
- Në krye të masave.
- Bëjnë shirit me shi.
- Qe vajza e Tantalit.
- Janë më shumë se dëshira
- Ishte dekret i sulltanit.
- Qe mbreti i urtë i Pilos.
- Quinn aktor.

- Gasol i NBA.
- Fillojnë garën.
- Një pjesë e reformave.
- Është si biskotë.
- Mund të jetë karmelitan.
- Sjellin shi.
- Bel i Maupassant.
- Direk pa ekstreme.
- Gjysma e bimëve.
- Mbyllin një motor.
- Është bitum.
- Fara këngëtare.
- Hanks aktor
- Stiller aktor.
- Morrison rockstar.
- Fillojnë masat.
- Në krye të tabelës.
- Derisa janë në fund.
- Fund filmi.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Film i hitchcock.
- Fillojnë premierën.
- Janë legjendat.
- Kush ka... ka zët.
- Thurman aktore.
- Një pjesë e testamentit
- Një pjesë e studimeve.
- Kështu është situata e tensionuar.
- Telefoni në kartvizitë.
- Është ngasje.
- Në krye të autoriteteve.
- Mbyllin mbledhjen.
- Pason abetaren.
- Nisin nga kreu.
- Fillojnë aafrimin.
- Cocker këngëtar.
- Bartok kompozitor.
- Tiriac që qe tenist.

VERTIKAL


- Janë enigmatikë.
- Emri i Vivaldit.
- Rrjedh në klepsidër.
- Inicialet e Selleck aktor.
- Fillojnë rubrikën.
- Ishte babai i Prokinit dhe Filomelës.
- Vitet pa kufij.
- Mbyllin kanate.
- U shit për një pjatë thjerza.
- ... e shëndoshë në trup të shëndoshë.
- Moore aktore.
- Rocca aktore.
- Janë përmasa.
- Fund dhjetori.
- Mbyllin krahum.
- Fillojnë kalimin.
- Duhen ruajtur.
- Ishte Europa komuniste.
- Agjenci Kombëtare Lokale
- Berg kompozitor.
- Të parat në Amsterdam.
- Elsa këngëtare.
- Memoria në computer
- Me të nxjerrin trarë.
- Në mes të dhomës.
- Ekstreme kateti.
- Kufijtë e lutjes.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

2	9				3			
1	4		5			2		
7	8		2		9	4	6	
				9				
				7	2			9
			3			2		
	7		3		6	8		
4	1	6	8		3			1

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

1	2	3	8	7	5	9	4	6
5	4	7	6	3	9	2	1	8
8	6	9	1	2	4	3	5	7
2	8	4	3	9	1	6	7	5
7	9	5	2	8	6	4	3	1
3	1	6	4	5	7	8	9	2
6	3	1	5	4	8	7	2	9
4	7	8	9	1	2	5	6	3
9	5	2	7	6	3	1	8	4

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Argëtim filozofik



- Meqenëse jeta dhe siguria e secilit është e lidhur me fatin e të gjithë atyre që, së bashku, formojnë kombin, do të na donte shpirti që çdokush të sakrifikojë pesë minuta në njëzet e katër orë dhe ...
- Mbiemri i vajzërisë së nënës së Astronautit Buzz Aldrin, pilotit të Apollo 11, që ishte astronauti i dytë i cili ishte i dyti që shkeli këmbën e tij në Hënë pas Neil Armstrongut, ishte Moon (Hënë).

Thënie të mënçura

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



- Të jesh me karakter do të thotë, të jesh
- drejtë edhe kur s'të sheh njeri
- Sikurse ndërtimi i shtëpisë nis nga themelet, e jo nga çatia, ashtu dhe
- ndryshimi vjen nga vetja, e pastaj nga shoqëria
- E vërteta është si drita, kurdo që të bëhet ndonjë vrimë, ajo del në sipërfaqe

PËRGJIGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

FJALËKRYQI (2)



www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al



Tashmë edhe lundroni!

